EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5467
E premte, 4 maj 2018
çmimi 0.40 €

Haradinaj, delegacionit të BE-së: Kosova është gati për vizat

FAQE 2

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHAR SELIMI FAQE 4-5

Sigurimi shëndetësor dhe rritja e pagave për policinë, çështje urgjente

- Duhet të gjendet një zgjidhje për sigurimin e policëve dhe për paga më të larta të tyre

Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, u ka bërë thirrje institucioneve që urgjentisht të gjejnë një zgjidhje për sigurim shëndetësor dhe jetësor të policëve. Ai ka thënë se në këtë aspekt Policia e Kosovës është më se keqi jo vetëm në Evropë, por edhe në botë.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Selimi ka bërë me dije se kufizimi i parasë publike në mallra dhe shërbime, si dhe riorganizimi i administratës, duke i hequr nga buxheti shumicën e agjencive të panevojshme, siguron mjete financiare për sigurim të policëve, ushtarëve dhe zjarrfikësve. Ai ka kërkuar që sa më parë të miratohet Ligji për policinë i cili parasheh pensionimin e parakohshëm të policisë. Po ashtu, Selimi u ka bërë thirrje institucioneve t'i gjejnë mënyrat adekuate edhe për rritjen e pagave të policisë

KUVENDI I KOSOVËS KA MIRATUAR REZOLUTËN PËR TË PAGJETURIT

Rezoluta e Kuvendit: Platforma e dialogut t'i përfshijë të pagjeturit

Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën për të pagjeturit, e cila e obligon Qeverinë ta zbardhë fatin e të zhdukurve me forcë. Kjo rezolutë, e cila ka 11 pika, e obligon ekzekutivin që zbardhja e fatit të të zhdukurve me forcë të vendoset si parakusht në dialogun Kosovë - Serbi dhe të bëhet pjesë e platformës shtetërore për dialogun FAQE 3

Gjendet trupi i pajetë i policit Malsor Dashi

Njësitë e kërkim-shpëtimit të FSK-së, të Policisë së Kosovës dhe të Agjencisë së Kosovës për Emergjenca, bashkë me vullnetarë të tjerë, kanë gjetur të enjten njërin nga dy trupat e pjesëtarëve të policisë, të cilët kanë rënë në lumin Lepenc. FSK-ja ka njoftuar se trupi i pajetë është i policit Malsor Dashi FAQE 5

AKTUALE

VETËM PERSPEKTIVA EKONOMIKE EVROPEIZON F. 11
SHKRUAN: AGRON HOTI

KOSOVA ANËTARËSOHET NË COST F. 6

PËR PESË MUAJ PARAQITEN TETË RASTE TË KËRCËNIMEVE TË GAZETARËVE F. 7

EKONOMI

LIMAJ E REÇICA NË FERIZAJ: PRIORITETI YNË, PUNËSIMI F. 9

'ISA BOLETINI' DHE DISA BIZNESE U BASHKOHEN PRODUKTEVE TË VALËS F. 8

KULTURË

POEMA 'ADEM JASHARI' E ILIR SHAQIRIT PROMOVOHET NË TIRANË F. 13

SPORT

AVDYLI: PO PRES FTESËN E CHALLANDESIT F. 18

AS HAXHI ZEKA S'E SHPËTON BESËN NGA HUMBJA F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

SatStyro Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Haradinaj, delegacionit të BE-së: Kosova është gati për vizat

Në takimin me delegacionin e BE-së për vlerësim të progresit në fushën e sundimit të ligjit, kryeministri Haradinaj ka paraqitur të arriturat e Qeverisë në sundim të ligjit, respektivisht përmbushjen e të gjitha kritereve në fushën legjislative dhe ka potencuar se Kosova është gati për liberalizimin e vizave

Prishtinë, 3 maj - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka takuar të enjten delegacionin e BE-së për vlerësim të progresit në fushën e sundimit të ligjit, të udhëhequr nga Simon Mordue, zëvendësdrejtor gjeneral në Drejtorinë e Përgjithshme për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi.

Kryeministri Haradinaj ka paraqitur të arriturat e Qeverisë në sundim të ligjit, respektivisht përmbushjen e të gjitha kritereve në fushën legjislative, ku ka theksuar punën e cila është bërë në procesimin e ligjeve të nevojshme të pakos për sundim të ligjit, siç janë ai për parandalimin e konfliktit të interesit, Prokurorinë e Shtetit, azilin dhe të huajt, financimin e partive politike etj., si dhe projektligjet e fushës së luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, siç janë Ligji i Agjencisë Kundër Korrupsionit, deklarimit të aseteve, mbrojtjes së informatorëve dhe autorizimeve të shtuara për konfiskim. Kryeministri Haradinaj ka theksuar se me takimet e nivelit të lartë që mbahen nën përkujdesjen e kryeministrit është rritur llogaridhënia e institucioneve relevante. "Në fushën e sigurisë Kosova ka shënuar sukses dhe mekanizmat e sigurisë tash janë më të fokusuara dhe më llogaridhënëse. Me të marrë Raportin e Progresit, Qeveria ka zhvilluar Planin e Veprimit për t'i adresuar sfidat e përmendura në Raportin e Komisionit Evropian 2018 në mënyrë specifike dhe të saktë. Gjithashtu, Kosova ka bërë progres në transparencë duke i publikuar kontratat publike dhe duke u përgjigjur në të gjitha kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare. Prioritet mbeten politikat e llogaridhënies, efektivitetit institucional dhe transparenca", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Kosova ka punuar shumë për përmbushjen e kritereve dhe është e përkushtuar t'i adresojë me sukses sfidat e mbetura. Kryeministri gjatë këtij takimi ka potencuar se Kosova është gati për liberalizimin e vizave.

LAJME SHKURT

Tahiri dorëzon mandatin: Nuk e shes dinjitetin tim për pushtet

Tiranë, 3 maj - Ish-ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Sajmir Tahiri, në një konferencë për medie mbajtur në Kuvend, deklaroi se dorëzon mandatin e deputetit deri në zbardhjen e të vërtetës dhe vendosjen në vend të drejtësisë lidhur me të.

"Dorëzoj mandatin e deputetit deri kur të zbardhet e vërteta e plotë. Unë nuk i përkas asaj race që shet dinjitetin për pushtet. Sot jam si dy milionë shqiptarët e thjeshtë në pritje të drejtësisë sime. Kjo nuk është ndeshja ime e fundit, por e para. Nga sot nuk jam më deputet. Do të përballem me këdo dhe s'do të dorëzohem e përkulem para askujt. Dua të falënderoj çdo qytetar që ka besuar tek unë. Unë jam Sajmir Tahiri e nuk kam nevojë për imunitet e Kuvend për t'u përballur me palaçot e politikës, sot e kurdo", tha Tahiri.

Tahiri tha se heshtja e tij prej gjashtë muajsh nuk është aspak shenjë dorëzimi, por vetëm respekt për të vërtetën e tij dhe drejtësinë. Ai lëshoi akuza të ashpra në drejtim të të gjithë klasës politike në Kuvend të cilët i ka cilësuar të gjithë palaço që i kanë pirë gjakun popullit në këta 25 vjet. Duke pranuar se puna e tij katërvjeçare në postin e ministrit të Brendshëm nuk ka kaluar pa gabime, Tahiri u shpreh se gjëja më e papranueshme është që gjyqin t'ia bëjë djalli, ose ata politikanë që për 25 vjet kanë vjedhur e vrarë dhe asnjëri prej tyre nuk u hetua, gjykua apo dënua. "Kam gjashtë muaj që dëgjoj lloj-lloj gjërash sa të kisha qeverisur për 30 vjet nuk do të kisha imagjinuar kurrë kaq shumë akuza kundër meje. Një herë kokë e mafies, një herë dru i shtrembër. Kjo është kur gjyqin ta bën djalli, jo se unë jam engjëll. Por kur e di se gjyqin ma bën ajo racë që ka qeverisur duke vjedhur. Më kanë thënë se më ka mbrojtur imuniteti, Rama, mazhoranca, edhe pse kam thënë vazhdimisht se nuk dua të më mbrojë asgjë. Tani dëgjoj që unë jam bërë pengesë për integrimin e vendit në BE, kur 25 vjet të mbushur me hajdutë, sot integrimin po ua pengoj unë. Jam përpjekur dhe ia kam dalë, nuk rri në kuvend për të pasur paprekshmëri, e jo më që rrugën për në Evropë e pengoj unë", ka thënë Tahiri.

Kryemadhi: Mandati i Tahirit, kompromis i Ramës për ta shpëtuar

Tiranë, 3 maj - Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, është skeptike për një arrestim të mundshëm të Sajmir Tahirit, pasi ky i fundit dorëzoi të enjten mandatin e deputetit. Në një dalje për mediet, Kryemadhi tha se ish-ministri i Brendshëm nuk mund të arrestohet, pasi organet e drejtësisë janë të kapura, sipas saj, nga kryeministri Rama. "Kjo është për t'i mbuluar gjëmat e mëdha që po vijnë. Dorëheqja e Tahirit apo dorëzimi i mandatit është qesharak, se më 19 prill vrapoi në seancë të mos humbte mandatin dhe sot del dhe e heq mandatin. Është ushtar i vogël i perandorisë së drogës së Ramës dhe kërkon t'u japë oksigjen grupeve kriminale. Është teatër fëmijëror, që nuk na hedh dot hi syve. Lotët e krokodilit që shikojmë nga ata që kanabizuan vendin janë shfaqje e shëmtuar që varfëron shqiptarët. Nuk e shpëtojnë dot Ramën nga përfshirja, se ai ishte ideatori dhe zbatuesi i kanabizimit, Tahiri ishte ushtar i vogël. Janë bërë qesharakë me kodet mafioze që i japin njëri-tjetrit në distancë që vetëm ata dinë t'i deshifrojnë. Për opozitën është fat i madh të akuzohet nga një njeri që e dinë ndërkombëtarët se çfarë është. Ky ishte kompromis i radhës i Ramës që, për të shpëtuar, e ka zakon të thotë jo mor burrë, i ka thënë atij, ik dy orë sa të harrohesh. Kjo është historia e këtij kontingjenti njerëzish që kemi sot një situatë ku nuk gjendet drejtësia", tha Kryemadhi.

Xhaferi: Nuk ngutem për firmosjen e Ligjit të gjuhëve

Shkup, 3 maj - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, nuk ka precizuar se cili është plani rezervë i tij për fuqizimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. I pyetur nëse dhe kur do ta dërgojë ligjin për publikim në Gazetën Zyrtare, Xhaferi tha se për këtë nuk është i kufizuar nga koha. Tashmë disa javë, Ligji për gjuhët, edhe pse mori votat e shumicës në Kuvend, nuk mori dekretin e presidentit dhe nuk është shpallur në Gazetën Zyrtare. "Këtu ishim për çështje tjetër. Mendoj se nuk është së pari korrekte që ta ndërrojmë temën. Mendoj se jam deklaruar qartë për atë punë. Nuk jam i ngarkuar me afate kohore sepse nuk ka kufizim kohor", deklaroi Talat Xhaferi, kryetar i Kuvendit.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën për të pagjeturit

Rezoluta e Kuvendit: Platforma e dialogut t'i përfshijë të pagjeturit

Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën për të pagjeturit, e cila e obligon Qeverinë ta zbardhë fatin e të zhdukurve me forcë. Kjo rezolutë, e cila ka 11 pika, e obligon ekzekutivin që zbardhja e fatit të të zhdukurve me forcë të vendoset si parakusht në dialogun Kosovë - Serbi dhe të bëhet pjesë e platformës shtetërore për dialogun

Muhamet KOCI

Prishtinë, 3 maj - Kuvendi i Kosovës me 71 vota për, 4 kundër dhe asnjë abstenim ka miratuar të enjten rezolutën për personat e pagjetur. Ky dokument, i cili ka 11 pika, e obligon Qeverinë e Kosovës që këtë çështje ta vendosë si parakusht në dialogun Kosovë - Serbi dhe ta bëjë pjesë të platformës shtetërore për dialogun. "1. Të bëhet zbardhja e fatit të të zhdukurve me forcë. 2. Zbardhja e fatit të të zhdukurve me forcë të vendoset si parakusht në dialogun Kosovë - Serbi dhe të bëhet pjesë e platformës shtetërore për dialogun. 3. Subjektet bartëse të politikës parlamentare dhe politikës së jashtme të Kosovës në agjendat e takimeve me zyrtarë të OKB-së dhe BE-së ta fokusojnë me prioritet zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me forcë", thuhet në rezolutë.

Në pikën katër, rezoluta parasheh që të gjithë bartësit e detyrave, në bazë të pikave të kësaj rezolute, t'i qasen në mënyrë të veçantë zbardhjes së fatit të Ukshin Hotit për shkak të rrethanave të zhdukjes së tij. "5. Qeveria e Kosovës ta përfundojë koncept-dokumentin dhe ta procedojë në Kuvend plotësim-ndryshimin e Ligjit për të pagjeturit, gjegjësisht bazës ligjore. 6. Qeveria të trajtojë me prioritet funksionalizimin e plotë të regjistrit qendror për personat e zhdukur, përfshirë edhe versionin elektronik me mundësi të digjitalizimit me qëllim të rritjes së transparencës. 7. Qeveria të angazhohet që të lidhë marrëveshje mirëkuptimi në mes të Kosovës dhe Serbisë për të ashtuquajturën ndihmë juridike ngjashëm me marrëveshjen që ka bërë Serbia me Bosnjë e Hercegovinën dhe Kroacinë", është thënë në këtë dokument, duke vazhduar në pikën tetë që institucionet kompetente ta padisin Serbinë si përgjegjëse kryesore për personat e zhdukur duke përfaqësuar familjarët individualisht ose si grup në instanca ndërkombëtare. "9. Qeveria obligohet ta realizojë projektin për shfaqjen e të dhënave rreth personave të zhdukur te përmendorja jashtë Kuvendit dhe të përfundojë puna e memorialit në Mejë të Gjakovës deri në fund të vitit 2018. 10. Të rriten kapacitetet institucionale të vendit për t'u marrë plotësisht me çështjen e personave të zhdukur me forcë. 11. Të hartohet dhe procedohet projektligji i cili mundëson gjykimin e të akuzuarve për krime të luftës në mungesë", ka përfunduar rezoluta.

Kjo rezolutë duhej të votohej më 27 prill në një seancë të jashtëzakonshme, e ftuar nga deputetët Andin Hoti dhe Saranda Bogujevci, por në atë seancë nuk kishte kuorum për ta votuar.

Vazhdon debati mes Halitit dhe Qunit për tetë milionë markat

Deputeti i PDK-së, Xhavit Haliti dhe ai i LDK-së, Anton Quni, janë përplasur përsëri rreth çështjes së luftës, pasi ky i fundit ka pretenduar se ka dorëzuar në Kuvend dëshmi për marrjen e tetë milionë eurove nga Xhavit Haliti, prej Ministrisë së Mbrojtjes së udhëhequr nga Ahmet Krasniqi.

Deputeti Haliti në seancën e së enjtes ka bërë me dije se Quni që nuk ka sjellë fakte dhe e ka ftuar atë t'i tregojë publikut. "Desha t'i them edhe një herë Anton Qunit, le t'i informojë mediet se nuk a ke sjellë asnjë dokument që dëshmon se unë i kam marrë tetë milionë, sepse po dezinformojnë mediet se ke argumentuar se i kam marrë tetë milionë. Unë s'i kam marrë 8 milionë. Të kam thënë atë ditë dhe po të them sot, por edhe ty si koleg po të them, interpretimin qysh e keni bërë në emisione është tjetër, por mirë është t'u thoni ta ndërprisni gënjeshtrën", ka thënë Haliti. Ndërsa kundërpërgjigjja e Qunit ka qenë se ka sjellë fakte, ani pse nuk ka treguar se çfarë faktesh. "Ju i keni të gjitha dëshmitë për të cilat shumë bëhet fjalë, është një ndër dëshmitë, normal që nuk kam arritur t'i siguroj të gjitha, por në ato dëshmi janë vula e Ministrisë së Mbrojtjes, janë numri i protokollit, janë protagonistët, janë krejt. Janë më shumë se 8 milionë euro që Qeveria e Kosovës i ka ndarë për nevojat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, për nevojat e komandantëve të zonave e të tjera, që të gjitha ju çdoherë i keni mohuar. Ndoshta ende po mendoni se jeni në vitin 1998-'99 kur keni marrë në pyetje njerëz të ndryshëm, i keni kërcënuar, i keni dhunuar, i keni abuzuar, por sot jemi në parlament", është shprehur Quni.

Përplasja ka shkuar edhe më tej, ku Haliti ka vlerësuar se nëse del një njeri që dëshmon se ai e ka rrahur, do të largohet nga posti i deputetit. "Nëse del një shqiptar, ose një përfaqësues i cilitdo komunitet që unë e kam marrë në pyetje, që unë e kam shantazhuar, që unë i kam thënë ndonjë fjalë të keqe, përveç në gjaknxehtësi me shokët e mi më shumë, unë nuk kisha qëndruar këtu. Unë nuk kam rrahur askënd, nuk kam vrarë askënd qysh po thua ti, s'kam marrë në pyetje, se s'ka qenë detyrë imja. Disa gjëra i di ti. S'po dua të flas. Por, ti sot edhe atë ditë ke gënjyer. Unë nuk kam nënshkruar dokument, sepse unë nuk kam nënshkruar me pseudonim kurrë me Qeverinë e Kosovës", ka deklaruar Haliti.

Haradinaj: AAK-ja, parti që karakterizohet me realen, ballafaquesen dhe besnikërinë

Prishtinë, 3 maj (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, me rastin e 18-vjetorit të themelimit të kësaj partie, ka thënë se Aleanca karakterizohet me realen, ballafaquesen dhe besnikërinë. "Realja, kur kemi dalë në skenë politike, atëherë ishin dy forca politike - LDK-ja dhe PDK-ja që shtyheshin me njëra-tjetrën. Përballja, për ne ikja nuk është zgjidhje, tërheqja nuk është zgjidhje, fshehja nuk është zgjidhje, problemeve u rrimë përballë, pra jemi përballur çdoherë me to. Nuk u frikësohemi as së tashmes dhe as së ardhmes. Kjo është karakteristika jonë e përballjes. Aleanca e ka pasur guximin kur ka bërë koalicion në 2004-n me ish-presidentin Rugova. Çdoherë do ta kemi guximin për t'u pajtuar në interes të vendit tonë. Besnikëria, Aleanca kur thotë po, ashtu mbetet. Këto tri vlera i kemi bërë reale në politikë", ka thënë Haradinaj, i cili mban postin e kryeministrit të vendit. Sipas tij, të tri këto karakteristika e kanë bërë AAK-në të jetë vetvetja dhe partnere e të tjerëve.

Në 18-vjetorin e themelit të AAK-së ishin të pranishëm lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ai i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, përfaqësues të tjerë të partive të tjera politike, deputetë të Listës Serbe dhe ambasadorë të vendeve të ndryshme që veprojnë në Kosovë.

Flet për "Epokën e re", Behar Selimi

Sigurimi shëndetësor dhe rritja e pa

- Duhet të gjendet një zgjidhje për sigurimin e policëve dhe për paga më të larta të tyre

Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, u ka bërë thirrje institucioneve që urgjentisht të gjejnë një zgjidhje për sigurim shëndetësor dhe jetësor të policëve. Ai ka thënë se në këtë aspekt Policia e Kosovës është më se keqi jo vetëm në Evropë, por edhe në botë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Selimi ka bërë me dije se kufizimi i parasë publike në mallra dhe shërbime, si dhe riorganizimi i administratës, duke i hequr nga buxheti shumicën e agjencive të panevojshme, siguron mjete financiare për sigurim të policëve, ushtarëve dhe zjarrfikësve. Ai ka kërkuar që sa më parë të miratohet Ligji për policinë i cili parasheh pensionimin e parakohshëm të policisë. Po ashtu, Selimi u ka bërë thirrje institucioneve t'i gjejnë mënyrat adekuate edhe për rritjen e pagave të policisë

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 3 MAJ -

"Epoka e re": *Z. Selimi, pas pesë ditëve të kërkimit, është gjetur trupi i pajetë i njërit prej dy policëve të rënë në lumin Lepenc. Si është menaxhuar nga organet përkatëse ky kërkim?*

Selimi: Personalisht jam i kënaqur me mënyrën se si i janë qasur kësaj fatkeqësie organet kompetente dhe qytetarët vullnetarë. Ka pasur reagim dhe koordinim institucional e shtetëror. Reagimet kanë qenë në përputhje me kapacitetet dhe mundësitë që i kemi si shtet. Duhet të kuptojmë se nuk kemi përvojë në këtë lloj të fatkeqësisë, prandaj edhe mund të ketë të meta. Megjithatë, reagimi dhe koordinimi kanë qenë në rregull. Kushdo që mendon ndryshe, ose i mungojnë informacionet ose e bën nga dhimbja dhe dëshpërimi për aksidentin e ndodhur. Për aq sa kemi informacione, rënia e dy policëve në lumin Lepenc ishte aksident tragjik.

"Epoka e re": *Megjithatë, ka pasur deklarata të ndryshme që linin hapësirë për dyshime.*

Selimi: Na mungojnë shumë informacione, por rasti është ende i hapur dhe hetimet janë duke vazhduar lidhur me rrethanat se si ka ndodhur aksidenti i policëve. Deri në përfundimin e hetimeve nuk mund të paragjykojmë dhe të nxjerrim përfundime profesionale. Deklarimet e ndryshme që kanë bërë janë në nivel spekulimesh, sepse pa përfunduar hetimet nuk mund ta konsiderojmë ndryshe, përveçse aksident me pasoja tragjike.

"Epoka e re": *Nuk ka pasur mundësi që gjetja e policëve të bëhet më shpejt?*

Selimi: Sipas mendimit tim, në këto situata nuk mund të bëhet diçka më tepër.

"Epoka e re": *Sa jeni i kënaqur me kushtet në të cilat funksionon dhe vepron Policia e Kosovës?*

Selimi: Sa i përket teknikës dhe teknologjisë së punës, gjendja është në nivel, pra ka buxhet dhe ka investime në pajisje. Problemi kryesor është mungesa e sigurimit shëndetësor dhe jetësor për policët. Kjo e keqe na ka përcjellë tash e dhjetë vjet që nga shpallja e pavarësisë së vendit. Në këtë aspekt, Policia e Kosovës është më se keqi jo vetëm në Evropë, por edhe në botë. Pra, sa i përket sigurimit të shëndetit dhe jetës së tyre, Policia e Kosovës është më se keqi në botë. Ky fakt duhet t'u shërbejë atyre që bëjnë politikë dhe marrin vendime që sa më parë të bëjnë një zgjidhje urgjente dhe jo të presin zgjidhje të përgjithshme për të gjithë qytetarët. Kërkohet zgjidhje e veçantë për policinë, për zjarrfikësit, për doganierët,

gave për policinë, çështje urgjente

për shërbimet e emergjencës dhe për gardianët. Për të gjitha këto shërbime që hyjnë në konceptin e shërbimeve me rrezik, duhet të gjendet një paketë e caktuar e sigurimit të jetës së tyre, sepse ata janë njerëz vazhdimisht me rrezik për jetën. Kërkohet një zgjidhje e shpejtë institucionale.

"Epoka e re": *Cilat janë masat urgjente që duhet të ndërmerren në këtë drejtim?*

Selimi: Fatkeqësisht po duhet të vdesë dikush për t'u aktualizuar kjo temë. Prandaj, sa më parë në mënyrë institucionale duhet të gjendet mënyra për sigurimin e jetës së policëve. Urgjentisht duhet të gjendet një zgjidhje e veçantë për policët, ushtarët, doganierët, zjarrfikësit dhe shërbimet emergjente. Apeloj te Qeveria dhe e kam një lloj besimi, sidomos të kryeministrit, me qëndrimin e tij prej njeriu që merr vendime dhe rrezikon t'i ndërmarrë masat e nevojshme në këtë drejtim, sepse pa rrezikuar nuk mund të merren vendime të duhura. Qeveria duhet të marrë vendim sa më parë dhe ta gjejë mënyrën e sigurimit të jetës dhe shëndetit për këto kategori. Pra, nuk duhet pritur që këto kategori të jenë në një paketë me të gjithë qytetarët, meqë profesioni i ka veçuar. Prandaj, kërkoj që kjo çështje të zgjidhet urgjentisht.

"Epoka e re": Besoni se kërkesa e juaj do të merret parasysh nga Qeveria dhe kryeministri Haradinaj?

Selimi: Shpresoj se çështja e sigurimit të jetës së policëve do të zgjidhet sa më parë. Edhe proceduralisht kjo çështje mund të kryhet tre deri në gjashtë muaj. Dua të besoj se kjo Qeveri do ta zgjidhë këtë problem.

"Epoka e re": *Përveç mungesës së sigurimit, ka zvarritje edhe për miratimin e Ligjit për pensionim të parakohshëm të policisë.*

Selimi: Këto zvarritje janë arsyetuar me reagimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Është e vërtetë se FMN-ja nuk lejon shpenzime, por nëse menaxhohet buxheti me mend dhe hiqet dorë nga shpenzimet e panevojshme, FMN-ja do të pajtohet. Pra, FMN-ja thotë se është në rregull nëse nuk kalohet buxheti prej dy miliardësh eurosh. Në përgjithësi në administratën publike të Kosovës ka mundësi të zvogëlohen shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve si dhe të zvogëlohet numri i agjencive të panevojshme, të dëmshme dhe të shtrenjta. Nëse paraja publike menaxhohet si duhet, do të ketë mjete për sigurimin shëndetësor dhe për Ligjin për pensionim të parakohshëm të policisë. Kufizimi i parasë në mallra dhe shërbime dhe riorganizimi i administratës, duke i hequr nga buxheti shumicën e agjencive të panevojshme, siguron mjete financiare për sigurim të policëve, ushtarëve dhe zjarrfikësve.

"Epoka e re": *Një problem tjetër sipas Sindikatës së Policisë së Kosovës vazhdon të mbetet edhe çështja e pagave, meqë ka kategori që bëjnë punë më të lehtë dhe paguhen më shumë se policët.*

Selimi: Fatkeqësisht, kjo është e vërtetë. Duhet gjetur mënyrën që policëve t'u rritën pagat. Sindikata e Policisë së Kosovës ka qenë shumë bashkëpunuese me të gjitha qeveritë e deritanishme. Unë ua përcjell një selam politikanëve që janë në pushtet, sepse edhe unë jam një farë politikani, por nuk jam në pushtet, që të mos e sprovojnë durimin e policisë. E njoh mirë këtë institucion dhe ata njerëz që janë shumë të devotshëm, të përkushtuar, ndoshta është pjesa më patriotike e vendit e cila vazhdon të shërbejë më shumë mbi bazën e idealit sesa mbi bazën materiale. Policinë nuk duhet sprovuar duke e detyruar të kalojë në sjellje sindikale që nuk i bëjnë mirë vendit. Është e nevojshme të gjendet një zgjidhje për sigurimin dhe pagat e policëve, sepse këto dy çështje janë vitale dhe emergjente. Kosovës i ka mbetur policia si një prej segmenteve më stabile, prandaj nuk është mirë që ky segment ta humbë durimin.

"Epoka e re": *Z. Selimi, a do të kandidoni për drejtor të përgjithshëm të policisë?*

Selimi: Kam marrë vesh se ka një disponim të atyre që u kam shërbyer të cilët kanë kërkuar që unë të rikthehem, mirëpo rikthimin tim në polici nuk e kam menduar në asnjë rast. Kur kam dalë nga policia kam menduar se do të marrë përgjegjësi në Ministri të Punëve të Brendshme (MPB) në mënyrë që gjërat që nuk kam mundur t'i bëjë si drejtor, t'i bëjë në kuadër të ministrisë. Kam menduar që përmes krijimit të politikave më të mira të krijojmë një sistem stabil, por kjo nuk ndodhi. Vitin e kaluar isha 4-5 muaj zëvendësministër, por nga ajo pozitë nuk pata mundësi të bëjë asgjë. Kam menduar se profesionalisht politika do të më shfrytëzojë në fushën e sundimit të ligjit, në drejtësi dhe në polici. Mirëpo kjo nuk ka ndodhur. Nëse ndodhë në të ardhmen dhe jam mirë me shëndet mund t'i dalë ballë asaj kërkese, por jo edhe kthimit në polici.

"Epoka e re": *Nuk ka gjasa të rikthehemi në krye të policisë?*

Selimi: Jo, nuk ka gjasa të rikthehem në polici. Unë e tregova adresën dhe rrugën se si mund ta ndihmojë policinë, por jo duke u kthyer në krye të saj. Atyre më së miri mund t'ju ndihmojë politika e qartë dhe njerëzit që e kuptojnë atë zanat. Këto nuk mund t'i bëjë drejtori i policisë, por Qeveria përkatësisht MPB-ja.

Gjendet trupi i pajetë i policit Malsor Dashi

Njësitë e kërkim-shpëtimit të FSK-së, të Policisë së Kosovës dhe të Agjencisë së Kosovës për Emergjenca, bashkë me vullnetarë të tjerë, kanë gjetur të enjten njërin nga dy trupat e pjesëtarëve të policisë, të cilët kanë rënë në lumin Lepenc. FSK-ja ka njoftuar se trupi i pajetë është i policit Malsor Dashi

PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Njësitë e kërkimshpëtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), të Policisë së Kosovës (PK) dhe vullnetarë të enjten kanë gjetur njërin nga dy trupat e pjesëtarëve të policisë të cilët kanë rënë në lumin Lepenc para disa ditësh. FSK-ja ka njoftuar se trupi i pajetë është i policit Malsor Dashi. "Njësitë e kërkimshpëtimit të FSK-së, të Policisë së Kosovës dhe AME-së (Agjencisë së Kosovës për Emergjenca) sot në orën 15:45, në kilometrin e pestë nga vendi i aksidentit, kanë gjetur trupin e pajetë të policit Malsor Dashi. Vazhdojnë kërkimet për trupin e policit tjetër", ka njoftuar FSK-ja.

Me t'u konfirmuar ky lajm, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka shprehur ngushëllime familjes së policit i cili është gjetur pa shenja jete në lumin Lepenc. Po ashtu, Thaçi ka falënderuar ekipet e kërkimshpëtimit dhe qytetarët të cilët kanë qenë të angazhuar për gjetjen e dy policëve të aksidentuar në magjistralen Kaçanik-Hani i Elezit. "Pas një pune të përbashkët të institucioneve dhe qytetarëve, sot ekipet e përfshira në kërkimin e dy policëve të zhdukur në lumin 'Lepenc' kanë gjetur trupin e pajetë të njërit prej tyre. Njësitet e FSK-së, të Policisë së Kosovës dhe qytetarët e angazhuar vullnetarisht i falënderoj për punën dhe mbështetjen e tyre, kurse familjarëve të të ndjerit u shpreh ngushëllimet më të sinqerta. Bashkëndjejmë me dhimbjen e tyre", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Familjen e policit e ka ngushëlluar edhe zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. "Bashkëndiej dhimbjen me familjarët e policit, trupi i të cilit u gjet në lumin Lepenc. Ngushëllime të sinqerta familjes!", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Dy policët Malsor Dashi e Armend Trena mesnatën e së shtunës janë përfshirë në një aksident në magjistralen Kaçanik - Han i Elezit.

Kosova anëtarësohet në COST

Qendresa RAMA

Prishtinë, 3 maj - Bordi Drejtues i Programit të Bashkëpunimit Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST) ka marrë vendim për përfshirjen e Kosovës në këtë program të rëndësishëm evropian si një vend i afërt i COST-it.

Ky lajm i mirë për hulumtuesit kosovarë i është komunikuar ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqit, nga presidenti i Asociacionit të COST, Sierd Cloetingh, përmes një letre, ku e ka uruar ministrin Bytyqi dhe hulumtuesit në Kosovë, të cilët i ka inkurajuar të vazhdojnë të angazhohen në veprimet e COST-it. "Si një vend i afërt i COST-it, hulumtuesit nga Kosova kanë të drejtë të rimbursohen për pjesëmarrjen e tyre në veprimet e COST-it, sipas rregullave ekzistuese të COST-it", është thënë në letrën e presidentit të Asociacionit, Sierd Cloetingh, i cili, ndër të tjera, ka shprehur dëshirën për t'i mirëpritur së shpejti hulumtuesit kosovarë në programin e bashkëpunimit evropian në shkencë dhe teknologji.

Anëtarësimi i Kosovës në COST, veç të tjerash, hapë mundësi të bashkëpunimit të shkencëtarëve tanë me shkencëtarë eminentë të fushave të ndryshme dhe është një mundësi e mirë për përfitimin e fondeve për hulumtime të ndryshme shkencore.

Ambasadori gjerman: Shpresoj se liberalizimi i vizave do të ndodhë shpejt

Prishtinë, 3 maj (ER) - Me rastin e 10-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike në mes të Gjermanisë dhe Kosovës, ambasadori gjerman në Prishtinë, Christian Heldt, ka bërë të enjten zbulimin e shtatores së "Ambasadorit" të Berlinit në Prishtinë, e ashtuquajtur "Arushë", e cila është punuar nga artistja e Kosovës, Arta Rudaku. Me këtë rast, ambasadori Heldt ka thënë se shpreson se liberalizimi i vizave do të ndodhë shpejt, vendim të cilin do ta marrë Komisioni Evropian. Ai ka folur edhe për vizitën e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, më 9 maj, me kancelaren gjermane Merkel, duke shpresuar se do të jetë një takim i mirë dhe i frytshëm ndërmjet tyre.

MAShT-i merr dy vendime për mbarëvajtjen e provimit të maturës

Prishtinë, 3 maj (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë të enjten dy vendime që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e Provimit të Maturës Shtetërore. Vendimi i parë është vendimi për lirimin nga pagesa për nxënësit që hyjnë në Provimin Shtetëror të Maturës, kurse vendimi i dytë që nxënësit që i nënshtrohen Testit të Maturës Shtetërore t'u ndalohen telefonat mobilë në qendrat e testimit si dhe kopjimi gjatë mbajtjes së provimit.

Këto vendime ministri i ka marrë në bazë të rekomandimeve të Komisionit Shtetëror të Maturës, i cili unanimisht ia ka rekomanduar këto vendime ministrit Bytyqi në mbledhjen e mbajtur sot. Me këto vendime nxënësve që u gjendet telefoni mobil në qendër të testimit, ose zihen duke kopjuar, do të përjashtohen nga testi për atë afat të testimit.

KDI-ja harton rregullore kundër ngacmimeve seksuale

KOSOVA DEMOCRATIC INSTITUTE

Prishtinë, 3 maj (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka bërë me dije se ka hartuar rregullore kundër ngacmimeve seksuale për krijim të ambientit të lirë dhe të barabartë në punë. Sipas një komunikate për medie të KDI-së, Kosova vazhdon të jetë vendi me papunësinë më të lartë në rajon, ndërsa gratë dhe të rinjtë janë më së shumti të prekur nga gjendja e rëndë në tregun e punës. "Krahas mosrespektimit të Ligjit të Punës dhe shkeljes së të drejtave të punëtorëve, diskriminimet në baza gjinore në vendin e punës ndikojnë negativisht në përmirësimin e gjendjes aktuale të tregut të punës. Andaj, me qëllim të eliminimit të çdo lloj diskriminimi në baza gjinore dhe për krijimin e një ambienti pune të lirë dhe të barabartë për të gjitha gjinitë, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka hartuar një rregullore kundër ngacmimeve seksuale, duke mundësuar krijimin e një mekanizmi që do të ndihmojë në parandalimin e ngacmimeve seksuale në vendin e punës", është thënë në komunikatën e KDI-së. KDI-ja ka bërë thirrje t'i bashkohen kësaj iniciative të gjitha institucionet qeveritare dhe joqeveritare për hartimin e politikave të brendshme të cilat garantojnë ambient pune të barabartë dhe të lirë për të gjithë, pavarësisht prej dallimeve gjinore.

Për pesë muaj tetë raste të kërcënimeve të paraqitura nga gazetarët

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) për pesë muaj ka pranuar tetë raste të kërcënimeve kundër gazetarëve. Kështu ka thënë të enjten me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, Majlinda Aliu nga AGK-ja

EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

Prishtinë, 3 maj - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka protestuar me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit me moton "Mosndëshkimi vret lirinë e shprehjes".

Majlinda Aliu nga AGK-ja ka thënë se Dita Botërore e Lirisë së Shtypit e gjen Kosovën në situatë jo të mirë sa i përket gjendjes së gazetarëve, sidomos në aspektin e sigurisë. "Vetëm gjatë këtyre pesë muajve ne në AGK kemi pranuar tetë raste të kërcënimeve, sulmeve fizike dhe dëmtimit të pronës së gazetarëve. Për të gjitha këto raste janë informuar organet e sigurisë dhe hetuesisë, mirëpo gjykatat nuk është se po tregohen shumë efikase për të marrë vendime konkrete", ka thënë Aliu.

Me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit ka folur edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili ka thënë se vendi ynë ka gazetarë të mirë dhe me integritet të lartë. "Gazetarët sot po e shënojnë në mënyra të ndryshme 3 Majin, Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit. Kosova, fatmirësisht, ka shumë gazetarë të mirë, me integritet të lartë dhe profesionistë të mirëfilltë, që në rrethana shumë të vështira e kanë mbajtur gjallë raportimin e drejtë dhe të paanshëm për qytetarët tanë", ka shkruar Thaçi në një postim në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se liria dhe pavarësia e Kosovës janë meritë edhe e shumë brezave të gazetarëve të Kosovës, që me guxim e përkushtim e raportuan të vërtetën për çdo proces nëpër të cilin kaloi vendi ynë. "Në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit ftoj të gjithë gazetarët ta vazhdojnë punën e tyre profesionale, hulumtuese dhe ta japin kontributin e tyre për forcimin e demokracisë dhe të shtetit tonë", ka thënë Thaçi.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka vlerësuar se institucioni më i lartë në vend do të jetë përherë i hapur për gazetarët. Veseli ka thënë se liria e fjalës është një ndër shtyllat themelore të shoqërisë demokratike. "Zhvillimi i medieve në Kosovë është një histori suksesi dhe liria e plotë e tyre është tejet e rëndësishme. Kuvendi i Kosovës do të jetë përherë i hapur për gazetarët. Këto ditë, në bashkëpunim me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës dhe NDI, kemi hartuar edhe Rregulloren për rendin dhe qasjen e medieve dhe publikut në punën e Kuvendit, e cila do ta mundësojë rritjen e mëtejme të transparencës. Liria e fjalës është një ndër shtyllat themelore të shoqërisë demokratike që synojmë të ndërtojmë. Këtë vlerë do ta mbrojmë e promovojmë", ka deklaruar Veseli në një deklaratë për medie.

Kurse kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se, sipas raporteve ndërkombëtare, Kosova ka bërë një përparim të ndjeshëm sa i përket lirisë së medies. Megjithatë, Haradinaj ka thënë se nuk do të ndalen deri në krijimin e një ambienti plotësisht të lirë e të sigurt për gazetarët. "Kosova, sipas raporteve ndërkombëtare, ka bërë një përparim të ndjeshëm sa i përket lirisë së medias, por ne nuk do të ndalemi derisa të krijojmë një ambient plotësisht të lirë e të sigurt për gazetarët. Liria nuk mund të jetë e pjesshme, prandaj i ftoj gazetarët kosovarë të punojmë në partneritet të ngushtë, që ta ndryshojmë këtë gjendje. Liria e shprehjes dhe e shtypit janë levat e demokracisë, kësisoj të panegociueshme dhe duhet të shkojnë bashkë të integruara me përgjegjësinë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Javën e ardhshme mbahet tryeza e partive e propozuar nga Veseli

Prishtinë, 3 maj (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, u ka dërguar të enjten ftesë krerëve të partive politike, për një tryezë diskutimi që ka për qëllim arritjen e konsensusit politik për agjendën shtetërore të Republikës së Kosovës. Takimi i thirrur nga Veseli do të mbahet më 8 maj në orën 13:00 në ambientet e Kuvendit të Kosovës.

Në këtë tryezë Veseli ka propozuar të diskutohet për çështjet më kryesore për shtetin, me theks të veçantë për: Fazën përfundimtare të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi; hartimin e Statutit për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe; agjendën e integrimeve evropiane; formimin e Ushtrisë së Kosovës; reformën zgjedhore. Veseli ditë me parë ka prezantuar edhe propozimplatformën për konsensus rreth këtyre temave.

'Isa Boletini' dhe disa biznese u bashkohen produkteve të Vala-s

A. MAVRAJ

Prishtinë, 3 maj - Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", një nga institucionet më të rëndësishme të këtij qyteti si dhe disa kompani private, iu bashkuan të enjten Telekomit të Kosovës, Vala, për t'i përdorur produktet dhe shërbimet e reja të telefonisë mobile dhe internetit. Nënshkrimi i këtyre kontratave do t'i sjellë Telekomit të Kosovës, Valës, një numër të konsiderueshëm të konsumatorëve të rinj, ndërsa bizneset do ta kenë më të lehtë komunikimin mes vete përmes pakove "PostPaid". "Sot nënshkruam kontrata të reja me Universitetin e Mitrovicës dhe me disa biznese private dhe për këtë fakt, jam shumë i lumtur, sepse personeli universitar dhe stafi i bizneseve i besuan dhe po i besojnë edhe më tutje Valës dhe për këtë arsye do të përfitojnë nga shërbimet tona atraktive, të cilat do t'u ofrohen me çmime shumë të favorshme", ka thënë ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Telekomit, Zeqir Kiqina.

Kompanitë nga Mitrovica që kaluan në Vala janë: "KRM 'Uniteti' Sh. A, 'Tehnoburimi', 'Loshi Company ShPK', 'BTP Holding Sh.P.K', 'NTP Loni Dekor', 'Sion Reisen'" etj.

Prorektori i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" dhe përfaqësuesit e këtyre bizneseve u shprehën të kënaqur me lidhjen e kontratave të reja, duke theksuar se Vala ofron shërbime cilësore dhe të pakonkurrueshme në krahasim me operatorët e tjerë. "Ne edhe në të kaluarën i kemi përdorur shërbimet e Valës, ndërsa sot lidhëm marrëveshje për shfrytëzimin e produkteve dhe shërbimeve të reja që do të na lehtësojnë komunikimin, rrjedhimisht edhe realizimin e punëve dhe detyrave tona të përditshme", ka

thënë Ali Sahiti, prorektor i Universitetit të Mitrovicës.

Pavarësisht prej rrethanave aktuale dhe vështirësive financiare me të cilat po përballet Telekomi i Kosovës, Kiqina edhe një herë shprehi optimizëm se menaxhmenti ekzekutiv dhe punonjësit e Telekomit të Kosovës do të arrijnë që me angazhimin dhe përkushtimin maksimal ta fuqizojnë imazhin e kompanisë, duke ia rikthyer konsumatorët e dikurshëm dhe duke fituar konsumatorë të rinj.

"Germania Airlines" së shpejti mund të bëhet kompani rezidente në Kosovë

Prishtinë, 3 maj (ER) - Avancimi i shërbimeve ajrore në Kosovë është interes i të gjithëve dhe bashkëpunimi me kompanitë serioze është në agjendën e Qeverisë së Kosovës. Kështu ka thënë të enjten kryeministri Ramush Haradinaj pas takimit që ka pasur me përfaqësuesin e Bordit Ekzekutiv "Germania Airlines", Sieghard Jahn.

Ky i fundit në këtë takim me kryeministrin ishte i shoqëruar edhe nga zëvendësambasadori i Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Jan Axel Voss dhe nga Haldun Kokturk, anëtar i Bordit të Drejtorëve dhe kryeshef ekzekutiv i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". "Gjermania e ka ndihmuar Kosovën në të gjitha etapat e shtetndërtimit dhe tani bashkëpunimi ekonomik është tejet i rëndësishëm dhe Qeveria e vendit është e përkushtuar ta çojë përpara këtë agjendë", është shprehur Haradinaj.

Pas Parkut Inovativ dhe trajnues në Prizren, operimi në Kosovë i "Germania Airlines" është një tjetër dëshmi e përkushtimit të Qeverisë për një partneritet të qëndrueshëm me shtetin gjerman. Përfaqësuesi i kompanisë "Germania Airlines" ka treguar synimet e veta për t'i zgjeruar operacionet në Kosovë, duke shtuar numrin e fluturimeve në destinacione të reja dhe pretendimin që në një të ardhme të afërt të aplikojë për statusin e kompanisë rezidente. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka ftuar kompanitë e tjera gjermane për të investuar në Kosovë, meqë vendi është i hapur dhe i sigurt për investimet e huaja direkte. Në këtë drejtim kryeministri ka premtuar përkrahje për iniciativa të shëndosha. Përfaqësuesi i Bordit Ekzekutiv i "Germania Airlines", Sieghard Jahn, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pritjen dhe për mbështetjen e dhënë për bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve.

Limaj e Reçica në Ferizaj: Prioriteti ynë, punësimi

"Rritja e punësimit është ndër prioritetet tona kryesore. Nuk do të lejojmë të ketë familje pa asnjë të punësuar", kështu ka thënë ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, të enjten në takimin me familjet përfituese të asistencës sociale në Komunën e Ferizajt, ku i pranishëm ishte edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj

Albulena S. MAVRAJ

Ferizaj, 3 maj - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, së bashku me zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj, janë duke vazhduar takimet me familjet përfituese të asistencës sociale nëpër komuna, me qëllim të jetësimit të projektit për punësimin e një anëtari të secilës familje që nuk e ka asnjë të punësuar.

Ministri Reçica dhe zëvendëskryeministri Limaj janë takuar të enjten me familjet përfituese të skemës së ndihmës sociale në Komunën e Ferizajt, ku i pranishëm ishte edhe kryetari i Ferizajt, Agim Aliu. "Ju keni shumë probleme, pakënaqësi e shqetësime, por përpjekja jonë dhe e juaja është për një jetë më të mirë. Është e pamundur të sigurohet një mirëqenie me një asistencë sociale. A ka mundësi shteti për ta rritur ndihmën sociale? Jo. Rruga është për t'i përvjelë mëngët dhe për të punuar", ka theksuar Limaj.

Ai ka shtuar se më mirë është për të punuar për 350 euro sesa për të pritur një ndihmë sociale nga shteti. "Nuk është krejt te paraja, por te shprehia e punës. Kemi nevojë për shprehi të punës. Ajo çfarë po kërkojmë ne është t'i ndihmojmë njëri-tjetrit. Pres nga ju ta kuptoni këtë mision që komuna dhe qeveria, posaçërisht ta mbështesim fort njëri-tjetrin. Edhe në këtë komunë të mos kemi raste kur një familje nuk e ka askënd të punësuar", ka theksuar Limaj.

Duke u larguar nga ndihma sociale, Limaj ka thënë se do t'u ndihmonin atyre familjeve që nuk mund të punojnë. Ai i ka lutur këto familje t'u drejtohen zyrave të punësimit dhe ta nisin punën. Ndërsa ministri i MPMS-së, Skender Reçica, ka thënë se kjo ministri është e përkushtuar për zbatimin e normave ligjore dhe hartimin e politikave për rritjen e punësimit. Duke mos qenë të kënaqur me aq sa është bërë deri më tani për këto familje, ministri Reçica ka thënë se është parë e nevojshme të niset me këtë projekt të rëndësishëm. "Papunësia në Kosovë nuk do të mbetet vetëm brengë e juaja. Kjo tashmë është brengë dhe përkushtimi yni, që ta luftojmë dhe mposhtim bashkërisht. Ju ftoj që këtë takim ta shohim bashkërisht si një partneritet i përbashkët, me qëllim të zbutjes së papunësisë", ka thënë Reçica.

Ky projekt, sipas ministrit, shkon përtej politikave të MPMS-së për punësim dhe ka përkrahje të fuqishme nga Qeveria e vendit, veçanërisht nga zëvendëskryeministri Limaj. "Një numër i konsiderueshëm i përfituesve, për shkak të kushteve jo të mira ekonomike, nuk kanë mundur të përgatiten profesionalisht. I ftoj të gjithë të paraqiten pranë Zyrave të Punësimit dhe t'i vizitojnë Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP), për t'i marrë trajnimet e nevojshme në një mori profilesh që ofrohen aty", ka thënë Reçica.

Ministri Reçica ka thënë se Qendrat e Aftësimit Profesional janë një mundësi e jashtëzakonshme për t'u aftësuar në një laramani profilesh që ofrohen në këto qendra dhe për t'u bërë pjesë e tregut të punës.

Reçica ka thënë se MPMS-ja është në kontakte të vazhdueshme edhe me biznese dhe ndërmarrje të ndryshme të cilat kanë shfaqur gatishmërinë të ofrojnë mundësi punësimi. Po sipas tij, MPMS-ja është duke punuar intensivisht me disa shtete të BE-së për mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjeve për punësim sezonal të qytetarëve tanë. "Rritja e punësimit është ndër prioritet tona kryesore dhe nuk do të lejojmë të ketë familje pa asnjë të punësuar", ka thënë Reçica.

Para disa ditësh ministri Reçica dhe zëvendëskryeministri Limaj janë takuar edhe me familjet përfituese të asistencës sociale në komunat Suharekë dhe Prizren, ndërsa takime të tilla do të vazhdojnë edhe në komunat e tjera.

Beqaj kërkon përkrahje për teknologjinë informative

Prishtinë, 3 maj (ER) - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, është takuar të enjten me ambasadorin jorezident të Dukatit të Madh të Luksemburgut, Paul Schmit, në një takim miqësor. Takimi i përbashkët i ministrit Beqaj dhe ambasadorit Schmit kishte karakter informues, për shqyrtim të mundësive për bashkëpunim në mes të Luksemburgut dhe Kosovës në fushën e teknologjisë informative dhe shfrytëzimin e potencialit të sektorit privat për shkëmbime tregtare, krijimin dhe zhvillimin e politikave që arsimi dhe shkenca t'i shërbejnë inovacionit dhe përmes tij të hapen mundësitë për zhvillim ekonomik. "Bashkëpunimi në fushën e kompetencës profesionale të rinisë së Kosovës të sektorit të teknologjisë informative dhe shfrytëzimi i potencialit të sektorit privat për shkëmbime tregtare janë disa nga pikat për të cilat u pajtuam me ambasadorin jorezident të Dukës së Madh të Luksemburgut për Kosovë, SHT Paul Schmit", ka thënë ministri Beqaj.

Temë e takimit ishte edhe mundësia e hapjes së një qendre të përbashkët të kompetencës për teknologji informative në kuadër të Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë që do të themelohet në Prishtinë. Duke qenë se Luksemburgu e ka shumë të zhvilluar arsimin profesional dhe zhvillimin e kompetencave në shërbim të tregut të punës dhe konkurrencës profesionale, ministri Besim Beqaj është shprehur i interesuar edhe për marrjen e përvojave të tilla dhe të ngjashme, për zhvillimin e ekonomisë, bazuar në potencialin e Kosovës, që është rinia e vendit.

Në Malishevë nënshkruhet marrëveshja për punësim

Malishevë, 3 maj (ER) - Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për punësim, në mes të Komunës së Malishevës, Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, do të krijohen mundësitë për punësim sezonal për 45 punëtorë. Në këtë projekt të partneritetit trepalësh, secila palë do t'i përmbushë kriteret dhe parakushtet të cilat kërkohen në marrëveshjen e nënshkruar.

Kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, është zotuar se pjesa e standardeve që i kërkohen komunës për t'i zbatuar ato do të përmbushen sipas bazës ligjore në fuqi për të gjithë të punësuarit. Kurse përfaqësuesi i Agjencisë Pyjore të Kosovës, Ahmet Zejnullahu dhe drejtori Faruk Bojaxhiu e kanë vlerësuar marrëveshjen shumë të dobishme për faktin se do ta shtojë edhe më shumë përkujdesjen për mbrojtjen e pyjeve, do të parandalojë shfrytëzimin e egër dhe të paligjshëm të pasurive në këtë komunë.

Sot mbahet takim i deputetëve me qytetarët e Gjakovës

Gjakovë, 3 maj (ER) - Në vazhdën e aktivitetit "Ditët e Kuvendit" sot (e premte) mbahet takimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës me qytetarë të Gjakovës. Takimi mbahet në Shkollën e Muzikës "Prenk Jakova" në Gjakovë dhe fillon në orën 14:00. Gjatë këtij takimi publik qytetarët e Gjakovës do ta kenë mundësinë të diskutojnë drejtpërdrejt me deputetët: Mimoza Kusari-Lila, Hajdar Beqa, Arbërie Nagavci, Driton Çaushi, Teuta Haxhiu, Haxhi Shala dhe Veton Berisha.

'Help'-i ndan 26 grante për bizneset në Mitrovicë

Mitrovicë , 3 maj (ER) - Organizata "Help-Hilfe zur Selbsthilfe" ka ndarë 26 grante për përfituesit e projektit "Mbështetja e stabilitetit socio-ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor". Në kuadër të këtij projekti të cilin e ka mbështetur organizata "Help", në objektin e Komunës së Mitrovicës janë nënshkruar kontratat për 26 përfitues në vlerë mesatare prej 2 000 eurosh.

Në ceremoninë e ndarjes së granteve i pranishëm ishte nënkryetari i Mitrovicës, Faruk Mujka, drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rrural, Ekrem Sadiku dhe përfaqësuesja e "Help"-it, Shqipe Breznica. Mujka ka falënderuar organizatën "Help", e cila edhe këtë vit, në kuadër të projekteve të tyre, ka përzgjedhur Komunën e Mitrovicës, duke i mbështetur bizneset fillestare dhe duke marrë pjesë për zbutjen e papunësisë dhe rritjen ekonomike.

Përfaqësuesja e "Help"-it, Shqipe Breznica, ka bërë me dije se qëllimi i kësaj organizate është ta mbështesë zbatimin e strategjive ekzistuese të zhvillimit lokal dhe ta përkrahë procesin e zhvillimit të qëndrueshëm në vend. Edhe përfituesit e granteve janë shprehur falënderues për kujdesin dhe mbështetjen e treguar nga komuna dhe organizata "Help".

Prishtina drejt anëtarësimit në Rrjetin Evropian të Qyteteve të Shëndetshme

Prishtinë, 3 maj (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, së bashku me përfaqësues të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe të Zyrës së OBSh-së në Prishtinë, ka vizituar të enjten Komunën e Prishtinës. Në këtë takim u diskutua për nisjen e procesit të anëtarësimit të qytetit të Prishtinës në Rrjetin Evropian të Qyteteve të Shëndetshme. "Qëllimi është të ndërtohen lidhje të fuqishme në mes të komunës, Ministrisë dhe OBSh-së, ashtu që të bashkëpunohet në vazhdimësi për një mjedis sa më të pastër dhe për një jetesë sa më të shëndetshme të qytetarëve", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës. Po në këtë takim janë përmendur edhe projektet që janë në realizim e sipër, të cilët do të ndikojnë për ruajtje të mjedisit, si ngrohja përmes koogjenerimit dhe plani i qëndrueshëm i mobilitetit.

Nderohet dëshmori Hasan Hasani

Obiliq, 3 maj - Me rastin e përvjetorit të dëshmorit Hasan Hasani, kryetari i komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, të enjten ka bërë homazhe pranë varrit të këtij dëshmori. "Në këto ditë lavdie kujtojmë me krenari të rënët për liri, me aq mall sa familjet, por me aq përkushtim për punën dhe shtetin tonë", ka thënë Gashi. Pos kryetarit të komunës, homazhe kanë bërë edhe përfaqësuesit e Shoqatës së Luftës së UÇK-së, qytetarë dhe familjarë të dëshmorit.

Vetëm perspektiva ekonomike evropeizon

Shkruan: Agron HOTI

Shikuar historiatin e Evropës pas Luftës së Dytë Botërore, na jep të kuptojmë se kontinenti ka kaluar nëpër dinamika pothuajse krejtësisht të ndryshme politike, ekonomike e sociale. Kishim dhe kemi një Evropë me vende si Holanda, Belgjika, Gjermania, apo Austria që kanë zhvillim dhe nevoja krejtësisht të ndryshme nga Evropa mediterane. Kishte një perde të hekurt që qartazi ndante prosperitetin demokratik perëndimor dhe regresin komunist lindor.

Kishim dhe kemi një Evropë Lindore, e cila, edhe pse prosperuese në zhvillim ekonomik, është duke u përballur me ndikim të theksuar rus e kinez, ndërkohë që kemi një Evropë Jugore që ka një rritje jo shumë prosperuese ekonomike. Deri më tani është dëshmuar se politikat që i sjellin përfitime një pjese të Evropës mund të mos i sjellin pjesës tjetër ose e kundërta. Si rezultat i këtij trendi është tepër e vështirë, nëse e pamundshme, të ketë unifikim të politikave mes vendeve anëtare të BE-së dhe institucioneve të BE-së.

Logjikisht, në qoftë se vendet eksportuese të BE-së synojnë, në fakt synojnë, sepse çdo shtet ka këtë synim - rritjen e mëtejme të eksportit të tyre brenda tregut evropian, kjo sigurisht se do t'i dëmtojë ekonomitë joeksportuese apo më pak eksportuese duke pamundësuar zhvillimin e aftësive konkurruese karshi vendeve të zhvilluara. Forcimi i primatit politik brenda BE-së përmes zhvillimit ekonomik ka rritur shqetësimin mes vendeve anëtare për rritje ndikimi dhe dominance të dikujtdikujt, njëkohësisht zbehje roli të dikujt tjetër.

Ky fenomen e ka përcjellë BE-në që nga fillet e tij e deri më sot, herë më shumë e herë më pak. Nuk thuhet rastësisht Evropa e "shpejtësive të ndryshme". Dhe tani kemi arritur në pikën ekstreme ku Britania e Madhe del prej BE-së duke dhënë mesazhin më goditës të mundshëm ndaj projektit të synuar evropian dhe të ëndërruar prej brezash.

Britania e Madhe asnjëherë nuk kishte arritur të vendosej, së paku kështu reflektonte në qendër të vendimmarrjes institucionale të BE-së. Dhe duke qenë e tillë, asnjëherë nuk qe bërë anëtare e Shengenit dhe Eurozonës.

Ndërkohë që perspektiva evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor është proklamuar dhe konfirmuar nga BE-ja në mënyrë konstante që nga Samiti i Zagrebit në vitin 2000 e deri më sot. Kjo perspektivë kishte dhe ka si synim kryesor kompletimin e projektit evropian duke ngërthyer në vete të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Përpjekjet për orientimin dhe përafrimin e Ballkanit Perëndimor drejt BE-së janë reflektuar edhe në Strategjinë e BE-së për Ballkanin Perëndimor të publikuar në shkurt 2018. Megjithatë, planet e BE-së për zgjerim dhe dalja e Britanisë së Madhe shkojnë ndesh mes asaj që synohet dhe asaj që nuk dëshirohet.

Edhe vizitat e shpeshtuara të krerëve të BE-së në rajon dhe Kosovë (Tusk, Juncker, Hahn, Mogerini etj.) kanë pasur për qëllim konfirmimin dhe materializimin për së afërmi të perspektivës evropiane për Ballkanin Perëndimor. Sigurisht se kjo ndërmarrje e krerëve të BE-së duhet të jetë më e shpeshtë duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat është duke u përballur rajoni, p. sh., ngecjet në reforma e zhvillimin ekonomik si dhe progresin e kufizuar në integrimin rajonal në pothuaj të gjitha dimensionet e tij.

Në qoftë se i referohemi tekstit të Strategjisë së BE-së për Ballkanin Perëndimor, atëherë shumë gjëra përsëritën nga dokumentet e mëhershme të BE-së që kishin të bënin me këtë rajon, përfshirë dhe Kosovën, që i bie se në shumë aspekte rajoni ka ngecur së zhvilluari mjaftueshëm dhe kjo është brengosëse. Janë pesë prioritete kryesore që kryesisht kanë të bëjnë me përmirësimin e qeverisjes, zhvillimin ekonomik, plotësimin e standardeve të BE-së dhe thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe këto prioritete përsëriten në vazhdimësi. Vetë fakti që prioritetet përsëriten konfirmon ngecjen zhvillimore të rajonit.

Edhe buxheti i BE-së do të jetë në refleksion të këtyre prioriteteve, por që forma e buxhetit nuk do të jetë investive, por vetëm zhvilluese institucionale. Sigurisht se të gjitha këto prioritete qëndrojnë dhe vendet duhet të punojnë në plotësimin e tyre, ose së paku ta japin indikacionin se janë në drejtim të mirë, por ajo çfarë urgjentisht i duhet rajonit është zhvillimi i gjithëmbarshëm ekonomik, i cili duhet të ndodhë krahas zhvillimit të sektorëve të tjerë, sepse ishte zhvillimi i hovshëm ekonomik i shoqëruar me vullnet politik ai që hapi rrugën e projektit evropian.

Pra, dimensioni i zhvillimit ekonomik të rajonit nuk është trajtuar sa duhet në Strategjinë për Ballkanin Perëndimor. E Ballkani Perëndimor dhe Ballkani në tërësi edhe sot mbetet rajoni më i pazhvilluar në Evropë në pothuaj të gjitha drejtimet. Shikuar nga aspekti historik ky rajon së bashku me Evropën Lindore nuk patën arritur ta kapin periudhën e industrializimit të shekullit 18 dhe 19. Të vetmen periudhë industriale Ballkani e kishte përjetuar pak para dhe gjatë periudhës së komunizmit, pra gjatë shekullit 20.

Pas rënies së komunizmit Ballkani pothuajse u deindustrializua i tëri, e me këtë humbën edhe tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Në aspektin e zhvillimit ekonomik, edhe pse ka ca progres, sidomos në projekte infrastrukturore, rajoni nuk ka mundur ta marrë veten si rezultat i së kaluarës, mungesës së investimeve në të tashmen dhe projeksioneve premtuese për të ardhmen. Si rezultat i kësaj i tërë rajoni i Ballkanit vazhdimisht përballej dhe përballet me qeverisje jostabile, zhvillim të ulët ekonomik dhe ngecje në reforma si rezultat i të cilave rajoni përballet me shkallën më të lartë të emigracionit në Evropë. Të gjitha këto "ushqejnë" praktika korruptive anë e përtej qeverisjeve të rajonit, të publikuara nëpër raporte të ndryshme ndërkombëtare.

Shikuar në retrospektivë, të gjitha iniciativave të BE-së, përfshirë Strategjinë e fundit për Ballkanin Perëndimor, pothuajse gjithmonë u ka munguar dimensioni i mirëfilltë i zhvillimit ekonomik të rajonit. Gjithmonë përqendrimi ka qenë në zhvillim institucional e shumë pak me përjashtim të numrit të kufizuar të projekteve infrastrukturore në zhvillim ekonomik, ajo çfarë më së shumti i nevojitet rajonit të dërmuar nga komunizmi dhe konfliktet.

E ndërkohë Evropa e kishte shembullin se si duhet ndihmuar vendet e dala nga lufta. Ishte Plani Marshall i ShBA-së ai që hapi shpresën për Evropën e shkatërruar nga Lufta e Dytë Botërore. Pra, BE-ja do të duhej të nxirrte vetë mësime nga Plani Marshall, sepse ishte pikërisht ky plan që nxiti projektin evropian, frytet e të cilit po i gëzojnë sot qytetarët evropianë. Pas Luftës së Dytë Botërore askush nuk pyeste për forcim të rendit dhe ligjit, por për riaktivizim të potencialit ekonomik të Evropës perëndimore si shpresa e vetme për të krijuar paqe dhe prosperitet në Evropë.

Plani Marshall u iniciua sepse në Evropën Perëndimore të asaj kohe shumica e qymyrgurit vinte nga minierat gjermane, të cilat, të shkatërruara nga bombardimet, nuk mund të riaktivizoheshin pa ndihmën e kapitalit të jashtëm. Papunësia ishte masive dhe industria kishte ngecur jo vetëm në Gjermani, por në tërë Evropën. Pa funksionalizimin e këtyre minierave, fillimi i zhvillimit ekonomik të vendeve të shkatërruara nga lufta as që mund të paramendohej. Ndërkohë, një rajon i pazhvilluar ekonomikisht rrezikonte Evropën të rrëshqiste drejt komunizmit duke sfiduar kështu ShBA-në dhe Perëndimin në përgjithësi si kundërshtarin e pakompromis ndaj komunizmit.

Prandaj, Plani amerikan Marshall, që mbështeti 16 vende të Evropës Perëndimore me 13 miliardë dollarë të asaj kohe (ekuivalenti i 100 miliardëve dollarë sot), u përqendrua në pikat më delikate të ekonomisë. Minierat e qymyrgurit ishin të parat që përfituan. Pa qymyrgurin për të vënë në punë fabrikat, ekonomia evropiane nuk do të mund ta merrte veten. Dhe efektet pozitive të Planit Marshall dihen: prodhimi i përgjithshëm kombëtar i Evropës Perëndimore u rrit mbi 30 % në katër vjetët e Planit Marshall, duke nxitur një rritje ekonomike afatgjatë si dhe duke siguruar kornizën e asaj që më vonë u bë Bashkimi Evropian.

Sigurisht se nuk mund të tërhiqen paralele mes gjendjes në të cilën ishte Evropa pas Luftës së Dytë Botërore dhe gjendjes në të cilën gjendej Ballkani pas rënies së komunizmit dhe konflikteve pasuese. Por, ngjashmëri patjetër që ka, sepse Ballkani Perëndimor është përballur me konflikte për 10 vjet rresht dhe kjo bëri që ekonomitë e rajonit të kolapsonin. Tensionet e vazhdueshme politike dhe socio-ekonomike, që janë duke e përcjellë Ballkanin Perëndimor sot, kanë krijuar një gjendje të atillë sa shkalla e emigracionit drejt vendeve të BE-së është ndër më të lartat në Evropë. Me një fjalë, rajonit i ka munguar ndonjë mbështetje financiare e theksuar nga ana e BE-së, e cila do të mund t'i kontribuonte zhvillimit ekonomik të rajonit.

Në qoftë se i referohemi buxhetit të BE-së, shohim se mbi 75 % të tij menaxhohet në partneritet me autoritetet nacionale dhe rajonale përmes sistemit të "bashkëmenaxhimit". Tashmë BE-ja ka pesë fonde të mëdha: Fondi Strukturor & Investimeve, Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal, Fondi Koheziv, Fondi Evropian Agro-Kulturor për Zhvillim Rural dhe Fondi Evropian për Ujëra dhe Peshkatari. Përpos këtyre fondeve, BE-ja ka një sërë fondesh të tjera, ndër të cilët vlen të përmendet Fondi Evropian për Investime Strategjike. Ky fond pritet që deri në vitin 2020 të investojë nëpër vende të ndryshme të BE-së deri në 500 miliardë euro për të nxitur zhvillim ekonomik gjithandej BE-së, rritje të konkurrencës, rritje të kapaciteteve prodhuese, përmirësim të infrastrukturës dhe krijim të vendeve të reja të punës. Më konkretisht, ky fond do të përdoret për ndërtimin e infrastrukturës së ujërave, gazit, telekomunikimeve, shpërndarje të energjisë elektrike dhe infrastrukturë të transportit. Por, ky fond nuk do ta mbulojë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Shikuar nga perspektiva e Ballkanit Perëndimor, shihet se ky rajon ka nevojë pikërisht për projektet e lartpërmendura, sepse janë pikërisht këto fusha që rajoni ka nevojë për mbështetje nga buxheti i BE-së. Mungesa e infrastrukturës së gjithëmbarshme në rajon kërkon aq shumë fonde sa vendet e rajonit nuk kanë mundësi të investojnë paralelisht në infrastrukturë, zhvillim ekonomik dhe zhvillim institucional. Kapacitetet e fondeve të IPA-s (Instrumenti i Para-Anëtarësimit) janë kryesisht të përqendruara në zhvillim institucional të vendeve përfituese të Ballkanit Perëndimor e shumë pak në nxitje të zhvillimit ekonomik.

Në anën tjetër, vakuumin e ngecjes në zhvillim ekonomik të rajonit janë duke tentuar ta shfrytëzojnë me përpikëri aktorë si Rusia, Kina dhe Turqia. Për dallim prej BE-së, këto tri vende nuk pyesin shumë për plotësim të kritereve të ndryshme si kushte paraprake për investim. Këto vetëm investojnë aty ku u jepet mundësia. E kjo mund ta vendosë rajonin në binarë të gabuar, pasojat e të cilit do të ishin të pariparueshme për Evropën, sepse këto iniciativa minojnë kompletimin e projektit të synuar evropian.

Shikuar historinë e Ballkanit Perëndimor, atëherë lehtë është të kuptohet që ky rajon asnjëherë nuk ka mundur t'i shmanget konkurrencës së fuqive të mëdha të manifestuara gjithandej dhe jo gjithmonë në interes të rajonit. Edhe sot rajoni i ekspozohet konkurrencës dhe përplasjes së aktorëve evropianë dhe joevropianë. Në qoftë se u lëshojmë një sy zhvillimeve në ardhje Evropë e gjetiu, është fare lehtë e kuptueshme që kjo dinamikë pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Prandaj, rajonit i duhet sa më shpejt të jetë e mundur një Fond Zhvillimor Rajonal, i cili do të nxiste zhvillim ekonomik, lehtësime për qasje në financa për biznese, hapje të vendeve të punës, përmirësim të infrastrukturës dhe në përgjithësi rritje të perspektivës afatgjatë për qytetarët e rajonit. Të gjitha këto do të ndikonin në uljen e shkallës së emigracionit, i cili ka filluar ta gërryejë nga brenda tërë rajonin.

Ndërkohë, zhvillimi ekonomik i rajonit do të hapte horizonte të reja drejt BE-së sepse rajoni do të integrohej më lehtë nëpër mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë; sa më shumë që integrohet rajoni, aq më të mëdha do të jenë detyrimet; sa më shumë detyrime ndërkombëtare, aq më e vogël do të ishte shkalla e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përndryshe, në qoftë se vazhdohet me avazin e vjetër, perspektiva e rajonit do të jetë tepër e ngadaltë dhe jotrenduale.

Irani nuk do ta rinegociojë paktin bërthamor

TEHERAN, 3 MAJ - Teherani nuk do ta rinegociojë marrëveshjen bërthamore të vitit 2015 që ka me fuqitë botërore, ka thënë ministri i Jashtëm iranian, Mohammad Javad Zarif. "Irani nuk do të rinegociojë atë për të cilin jemi pajtuar vite më parë dhe që tani është në zbatim", ka thënë Zarifi në një video të postuar në "YouTube".

Presidenti amerikan Donald Trump është kritik i ashpër i marrëveshjes, sipas së cilës, Teherani është pajtuar për ta kufizuar programin bërthamor në këmbim të lirimit nga sanksionet. Trumpi u ka dhënë afat vendeve nënshkruese evropiane deri më 12 maj për t'i rregulluar ato që ai i ka cilësuar si "të meta të tmerrshme" të paktit, duke kërcënuar se do ta tërheqë Uashingtonin nga i njëjti.

Zarif ka thënë se Shtetet e Bashkuara kanë shkelur vazhdimisht marrëveshjen, duke parandaluar të tjerët të bëjnë biznes me Iranin.

Në të njëjtën kohë, sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, është deklaruar më 3 maj kundër prishjes së marrëveshjes bërthamore. "Nëse një ditë do të ketë marrëveshje më të mirë për ta zëvendësuar atë që është aktualisht në rregull, mirëpo ne nuk mund ta prishim këtë që kemi pa ndonjë alternativë tjetër", ka thënë Guterres për BBC.

Vendet e tjera që kanë nënshkruar marrëveshjen, Franca, Britania, Gjermania, Rusia dhe Kina, i kanë bërë thirrje Uashingtonit të jetë pjesë e paktit, ndonëse edhe aleatët perëndimorë kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me kushtet e marrëveshjes.

50 vjet pas protestave të majit 1968 në Francë

Trazirat e majit 1968 filluan si protesta studentore me thirrjet për më shumë liri, por u përhapën në fabrika dhe thuajse paralizuan ekonominë, duke arritur të mobilizojnë deri në një milion protestues që marshuan në Paris me thirrjet për dorëheqjen e presidentit të moshuar, heroit të Luftës së Dytë Botërore, Charles de Gaulle



PARIS, 3 MAJ - Kanë kaluar 50 vjet që nga trazirat sociale të majit 1968 në Francë. Në këtë përvjetor rrugët e Parisit janë të mbushura me protestues që po shprehin kundërshtimin e tyre ndaj reformave të Qeverisë centriste të Emmanuel Macronit. Por këtë herë energjia dhe fryma e protestave dallojnë shumë nga trazirat që përfshinë Francën gjysmë shekulli më parë dhe që lanë një gjurmë të përhershme në historinë dhe shoqërinë e vendit.

Protestat që shoqërojnë si gjithmonë ditën e 1 Majit, u rishfaqën këtë javë dhe pritet të pasohen me një muaj tubimesh e demonstratash nga studentë e punëtorë të revoltuar. Këto pamje ta kujtojnë Francën e 50 vjetëve më parë.

Trazirat e majit 1968 filluan si protesta studentore me thirrjet për më shumë liri, por u përhapën në fabrika dhe thuajse paralizuan ekonominë. Ato arritën të mobilizojnë deri në 1 milion protestues që marshuan në Paris me thirrjet për dorëheqjen e presidentit të moshuar, heroit të Luftës së Dytë Botërore, Charles de Gaulle. Pas të gjitha protestave, partia e tij fitoi në zgjedhjet parlamentare një muaj më pas.

Por revolta pati efekte afatgjata. Një vit më pas De Gaulle dha dorëheqje.

Protestat e 1968 ishin shumë më tepër se një revoltë publike. "Protestat ishin edhe për lirinë seksuale, të drejta politike, për muzikën. Ishin thirrje për shpirtin krijues të rinisë, larg nga tutela e prindërve", thotë historiania Nicole Bacharan.

Por të tjerët mendojnë se protestat kryesisht mbollën kaos. "Ata digjnin makina. Gjithë ideja ishte 'të shkatërrojmë thjesht për të shkatërruar'. Nuk donin të lodheshin për t'u arsimuar. Donin shkollë pa konkurrim", thotë publicisti Jean Picollec.

Kaos ka pasur edhe gjatë protestave të kësaj jave, por për arsye të tjera.

Protestat e 1968-s filluan në Universitetin Nanterre, pranë Parisit, ku gjatë javëve të fundit studentët kanë bllokuar rrugët duke kundërshtuar kërkesat e reja për pranim në shkollë. "Kemi kërkesa të ngjashme, duam më shumë liri dhe të drejta për këdo dhe arsim më cilësor", thotë Manel Djadoun, kryetare e Unionit Komunist Studentor të Universitetit Nanterre.

Edhe punonjësit e hekurudhave janë ngrehur në protesta kundër planeve të Qeverisë për ta reformuar sistemin kombëtar të transportit hekurudhor. Punonjësit e kompanive të fluturimeve, sektorit të shëndetësisë, aktivistët për të drejtat e imigrantëve dhe grupet antikapitaliste janë mobilizuar. Por këto trazira dallojnë nga protestat e 1968-s. "Lëvizja e 1968-s ishte shumë më kolektive, më e përgjithshme, me një agjendë më radikale për ta ndryshuar politikën dhe Qeverinë. Nuk është ashtu sot", thotë një protestues.

"Tani, në Francë, njerëzit nuk protestojnë me thirrjet për liri apo për ta ndryshuar botën, por për siguri sociale e mbrojtje", thotë historiania Nicole Bacharan.

Protestat e majit 1968 përmbyllën një epokë. Presidenti aktual i Francës, Emmanuel Macron, i përket një epoke të re. Ai nuk kishte lindur ende në 1968-n, por Macron duhet të përgatitet për vazhdimësinë e një tradite: protesta, demonstrata dhe thirrje të revoltuara në javët e muajt në vazhdim.

Qeveria spanjolle, skeptike për shpërbërjen e ETA-s

MADRID, 3 MAJ - Qeveria spanjolle nuk është mjaftuar me faktin që grupi separatist bask ETA i ka dhënë fund luftës për një shtet të pavarur bask në Spanjën Veriore dhe në Francën Jugore.

Ministri i Brendshëm i Spanjës, Juan Ignacio Zoido, është skeptik rreth shpërndarjes së ETA-s pas 60 vjetësh dhe tha se qeveria do të vazhdojë t'i ndjekë ata, që i cilësoi si terroristët baskë. "Ata nuk do të ishin shpërbërë kurrë. Ata u shpërbënë nga forcat e sigurisë të shtetit spanjoll. Ata ishin mposhtur dhe e vetmja gjë që duhet të bënin ishte bashkëpunimi dhe ndihma sepse gjithçka tjetër ishte bërë përmes zbatimit të ligjit", tha ai.

Grupi ETA, emri i plotë i të cilit në gjuhën baske përkthehet "Atdheu bask dhe liria", është përgjegjës për rreth 850 vdekje në fushatën e saj të dhunës dhe terrorizmit në luftën për shkëputjen e rajonit Bask. Militantët baskë e themeluan grupin si përgjigje ndaj diktatorit ushtarak të Spanjës Francisco Franco, i cili e ndaloi përdorimin në publik të gjuhës baske.

Ambasada e ShBA-së dhuron 560 libra për Departamentin e Gazetarisë në UP

PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë ia ka dhuruar 560 libra Departamentit të Gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Këta libra kanë të bëjnë me mediet dhe janë dhuruar si donacion me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit.

Drejtoresha e Institutit të Medies në Departamentin e Gazetarisë, Remzie Shahini-Hoxhaj, ka thënë se këta libra do të shërbejnë për edukimin dhe arsimin e gazetarëve të rinj. Ndërsa Richard Mei nga Ambasada e ShBA-së në Kosovë ka thënë se liria e shtypit është shumë e rëndësishme për një shtet demokratik. Ai ka inkurajuar studentët dhe stafin e këtij departamenti ta vazhdojnë punën e tyre në këtë drejtim.

Me rastin e dhurimit të këtij fondi librash nga Ambasada e ShBA-së në Kosovë për Departamentin e Gazetarisë, disa tituj u janë dhuruar studentëve të pranishëm.

Krejt në fund nga përfaqësuesit e kësaj ambasade është bërë me dije se konkursi për studime master në Amerikë është hapur për studentët e Kosovës që duan t'i vazhdojnë studimet atje.

Poema 'Adem Jashari' e Ilir Shaqirit promovohet në Tiranë



TIRANË, 3 MAJ (ER) - Me një ceremoni të veçantë organizuar nga Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës (LShK-së) për nder të Ditës së Dëshmorëve, sot (e premte) në Muzeun Kombëtar në Tiranë do të promovohet poema "Adem Jashari" nga këngëtari dhe shkrimtari i mirënjohur i Kosovës, Ilir Shaqiri.

Për librin më të ri të Ilir Shaqirit pritet të flasin studiues dhe kritikë letrarë nga Prishtina (Shyqri Galica, Abdyl Kadolli dhe Arben Veselaj) dhe Tirana (Kudusi Lame), ndërkaq aktorët Bujar Asqeriu, Llesh Nikolla dhe Yllka Mujo do të deklamojnë pjesë nga vepra.

Ka disa vjet qëkur Ilir Shaqiri i është rikthyer pasionit të tij të hershëm për letërsinë. Para poemës "Adem Jashari" ai ka botuar dy romane "Tan Temali" dhe "Lemza e dheut", ndërkaq ka botuar edhe një libër me studime nga fusha folkloristikës dhe estetikës me titull "Estetika dhe semiotika në krijimtarinë e nënës".

Konferenca e arkivistëve Kosovë - Shqipëri mbahet më 9 qershor në Prishtinë

PRISHTINË, 3 MAJ - Konferenca e Dytë Mbarëkombëtare e Arkivistikës do të nisë më 9 qershor në Prishtinë, në një bashkëpunim mes Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave me homologen e Kosovës. "Qëllimi i kësaj konference është t'i mbledhë bashkë arkivistët e Shqipërisë dhe të Kosovës, arkivistët shqiptarë të viseve jashtë Shqipërisë, por që veprojnë ndër shqiptarë, nga Maqedonia dhe Mali i Zi, si dhe të tjerë arkivistë që punojnë apo studiojnë në fushë të arkivistikës. Temat që propozohen për diskutim lidhen specifikisht me arkivistikën, por edhe me historinë e arkivave apo institucioneve arkivore në zonat shqipfolëse", ka bërë me dije zëdhënësja e DPA-së, Elsa Saka.

Veç arkivistëve të rrjeteve arkivore kombëtare, ftesa për pjesëmarrje u drejtohet të gjithë profileve të tjerë të arkivistëve, institucioneve që ruajnë apo atyre që ndërveprojnë me ruajtjen e kujtesës kolektive. Viti Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu është një shans i artë për të gjithë arkivistët dhe historianët për t'i përafruar praktikat profesionale në viset kombëtare. DPA u bënë thirrje të gjithë studiuesve të bashkohen në këtë përpjekje për ta trajtuar historinë kombëtare njëjtrajtshmërisht, pavarësisht prej kufijve politikë.

Meta në Krujë: Mirënjohje arbëreshëve për ruajtjen e gjuhës dhe traditave

KRUJË, 3 MAJ (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka qëndruar në Krujë me shoqatën arbëreshe nga Kalabria ku është përkujtuar rrugëtimi historik i Skënderbeut. Ai ka shprehur mirënjohjen për arbëreshët dhe kontributin e tyre në shekuj për ta ruajtur gjuhën e traditat që në kohën e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. "Sot në Krujë, me Shoqatën Arbëreshe nga Kalabria 'Magna Grecia Off-Road', përkujtuam rrugëtimin historik të heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në kryeqendrën arbërore. Skënderbe, arbëreshë dhe Shqipëri janë një trinom i pandashëm. Mirënjohës përjetë arbëreshëve për kontributin madhor që kanë dhënë në shekuj për ta ruajtur gjuhën, traditat, ritet e kulturën, në veçanti për lartësimin e emrit dhe figurës së Skënderbeut. Një falënderim të veçantë edhe për punën e palodhur dhe të mrekullueshme të Aldo Morinos, konsullit tonë të nderit në Kalabri", ka deklaruar presidenti Meta.

E rrallë

Studentja me sindromën Down diplomohet me notën maksimale

Giulia Sauro është 33-vjeçare dhe vuan nga sindroma Down. Sëmundja e saj nuk e ka penguar atë t'i vazhdojë studimet. Ajo ishte shumë e vendosur në këtë drejtim dhe ka përfunduar studimet universitare, duke diplomuar në drejtimin Shkenca Politike në Universitetin e Napolit me maksimumin e pikëve, raporton "tgcom".

FOTO E DITES

Pamje e natyrës së bukur nga bjeshka e Rugovës në Pejë.
/Foto: G. DINAJ/

E jashtëzakonshme

Një grua lë bashkish gabimisht 7 680 dollarë në një qebaptore

Një grua ka lënë aksidentalisht 7 680 dollarë bakshish në një qebaptore. Kur ajo shkoi për ta paguar faturën me kartë krediti, në vend se ta shtypte numrin e shumës që dëshironte të linte bakshish, shtypi kodin e PIN-it. 'Bakshishi i ekzagjeruar'

është lënë nga rusja Olesya Shemyakova në një qebaptore në Dietikon në Zvicër.

BARSOLETA E DITËS

- Mami, shokët tallen me mua, thonë se kam këmbë shumë të mëdha.
- Bëjnë shaka, shpirti i mamit. Hajde tashti, shko parko këpucët në garazh se do të hamë drekë.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

"BLACK PANTHER" 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

"PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck

Në ora19:00

"PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight

Në ora21:00

"RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI Me shumë mençuri arrini të menaxhoni çfarëdo lloj situate që do t'ju ofrojë dita.

DEMI Edhe pse sot personat afër jush ju ndiejnë larg përfshirjes në biseda, kjo është një strategji e mirë për të mos dalë kundër tyre.

BINJAKËT Projekte të reja dhe ecje në karrierën tuaj profesionale po paraqiten në horizont. Do t'i kapni në ajër dhe do të përfitoni nga kjo gjë.

GAFORRJA Në çështje pune dhe ato familjare jeni autoritar dhe jepni gjithmonë zgjidhjen përfundimtare. Njerëzit që keni pranë besojnë te ju.

LUANI Sot do të përfundoni gjithçka që keni lënë pezull nga java e kaluar. Shpirti juaj i iniciativës sot do të jetë vendimtar në zgjidhjen e problemeve.

VIRGJËRESHA Nuk është e nevojshme të jepni mend edhe për ato çështje që nuk i njihni mirë. Ndonjëherë të dëgjosh zgjidh më shumë punë sesa të flasësh.

PESHORJA Do të jeni rebel dhe nervoz sot pa ndonjë shkak ose arsye. Kjo gjë do t'ju bëjë të jepni vendime të dyshimta lidhur me disa çështje.

AKREPI Ndjenjat dhe emocionet sot do të jene primare në ditën tuaj. Çdo gjë duket se shkon ashtu siç duhet dhe do të udhëhiqeni nga zemra.

SHIGJETARI Mos lejoni që stresi ta shkatërrojë ditën e sotme. Edhe pse do të keni disa vonesa në çështje të caktuara, nuk është fundi i botës.

BRICJAPI Keni plane afatgjata lidhur me një person të caktuar, por do të ishte mirë që ai të ishte në dijeni të ndjenjave tuaja për të.

UJORI Problemet që mund t'ju dalin sot në punë mund t'i zgjidhni vetëm duke ruajtur qetësinë dhe pa ju kapur paniku.

PESHQIT Gjithë dita juaj sot do të kalojë në një pështjellim ndjenjash dhe arsyesh. Nuk po dini të ndani disa gjëra që ju shqetësojnë.

Rihanna jep këshilla grimi

Rihanna ka kohë që nuk ka publikuar ndonjë projekt muzikor dhe është fokusuar në biznesin e saj me produkte kozmetike. Së fundmi ajo ishte personazh i ftuar nga revista "Vogue", ku ka treguar se si e bën makijazhin kur i duhet të grimohet vetë. Ajo nuk ka ngurruar që përmes kësaj videoje t'i bëjë edhe reklamë disa prej produkteve të saj "Fenty Beauty".

Rita Ora mban koncert në Kroaci

Këngëtarja me prejardhje shqiptare, Rita Ora, po shkon për herë të parë në Kroaci. Ajo do të mbajë një koncert në Porec, në Festivalin e Rise Up, i cili do të mbahet nga 6 deri më 8 korrik. Biletat janë në shitje me çmimin prej 17 eurosh, por vetëm deri të dielën (më 6 maj).

Tuna u jep fund spekulimeve për ndarjen nga partneri

Kohët e fundit është përfolur se këngëtarja e njohur Tuna i kishte dhënë fund marrëdhënies me partnerin Patris Berisha, por ajo ka hedhur poshtë një gjë të tillë. Për ditëlindjen e parë të djalit Tian ata kanë dalë të lumtur e të qeshur duke pozuar. Tuna ka publikuar një fotografi në rrjetin social në "Instagram" duke u dhënë fund thashethemeve.

Kylie Jenneri, në pushime bashkë me familjen

Kylie Jenner dhe i dashuri i saj Travis Scott janë fotografuar duke shijuar pushimet familjare së bashku me vajzën e tyre Stormi në Bahamas. Ylli i televizioneve ka ekspozuar format e saj trupore vetëm pak muaj pas lindjes dhe duket shumë në formë. Kylie dhe Travisi zgjodhën ta kalojnë kohën në një jaht luksoz, ndërsa vajza e tyre e porsalindur u fotografua në duart e një dadoje që kujdesej për të.

I sëmurë në Ballkan, parà në dorë ose prit!

Mjekët po rrallohen e radhët në klinika shtohen. Kujt është i sëmurë në Ballkan i duhet durim. Ose të ketë shumë para. Por paralelisht me sistemin shtetëror është krijuar një botë paralele klinikash private

"Këtë mund ta zgjidhim privatisht". Kjo fjali magjike dëgjohet rregullisht në Ballkan, edhe Natasha e dëgjoi, kur donte të mbyllte një orar për kontroll në spital. 30 vjeçarja nga Novi Sadi sapo ka lënë pas vuajtjet e një tumori në sistemin limfatik dhe nuk do të humbasë kohë. Por ajo nuk ka para për të paguar "privatisht", jashtë sistemit të siguracionit shëndetësor shtetëror vizitën mjekësore.

Shumica e pacientëve në vendet e Ballkanit që përbënin dikur Jugosllavinë socialiste janë të varur nga sistemi shëndetësor shtetëror. Për qytetarët në Serbi, Maqedoni apo Bosnje, ku rroga mesatare është rreth 400 euro neto dhe papunësia kalon 20%, kontrollet private tek mjeku janë një luks i paarritshëm. Këtë hap pacientët e ndërmarrin vetëm në rast nevoje, kur pritja e gjatë kthehet në rrezik për shëndetin. Ose kush ka para.

Nuk ka shiringa dhe gjilpëra

"Vajza ime u sëmur nga diabeti, kur ishte 16 muajshe. Kemi pritur më shumë se 6 vjet për një pompë insuline", kujton Mirela Shishiç, që drejton një shoqatë pacientësh në kryeqytetin boshnjak, Sarajevë. Për Deutsche Wellen ajo thotë, se spitalet nuk kanë as medikamentet bazë, megjithëse ato duhet të mbulohen nga siguracioni shëndetësor. Ilaçet që nuk i ofrojnë spitalet qytetarët i blejnë pastaj me çmim të plotë në farmaci.

Siguracioni shëndetësor shtetëror ofron shumë pak mjete financiare, shprehet një ish-drejtor që nuk do të përmendet me emër, dhe që për vite me radhë ka drejtuar disa spitale në Serbi. "Kështu në pjesën e dytë të vitit mungojnë gjilpërat, shiringat, dhe dezinfektuesit. Pa harruar pjesët për aparatet e radiografisë." Ndërkohë ai punon tani për një spital privat, që nuk i ka këto probleme.

"Këtë mund ta zgjidhim privatisht". Kjo fjali magjike dëgjohet rregullisht në Ballkan, edhe Natasha e dëgjoi, kur donte të mbyllte një orar për kontroll në spital. 30 vjeçarja nga Novi Sadi sapo ka lënë pas vuajtjet e një tumori në sistemin limfatik dhe nuk do të humbasë kohë. Por ajo nuk ka para për të paguar "privatisht", jashtë sistemit të siguracionit shëndetësor shtetëror vizitën mjekësore.

Shumica e pacientëve në vendet e Ballkanit që përbënin dikur Jugosllavinë socialiste janë të varur nga sistemi shëndetësor shtetëror. Për qytetarët në Serbi, Maqedoni apo Bosnje, ku rroga mesatare është rreth 400 euro neto dhe papunësia kalon 20%, kontrollet private tek mjeku janë një luks i paarritshëm. Këtë hap pacientët e ndërmarrin vetëm në rast nevoje, kur pritja e gjatë kthehet në rrezik për shëndetin. Ose kush ka para.

Nuk ka shiringa dhe gjilpëra

"Vajza ime u sëmur nga diabeti, kur ishte 16 muajshe. Kemi pritur më shumë se 6 vjet për një pompë insuline", kujton Mirela Shishiç, që drejton një shoqatë pacientësh në kryeqytetin boshnjak, Sarajevë. Për Deutsche Wellen ajo thotë, se spitalet nuk kanë as medikamentet bazë, megjithëse ato duhet të mbulohen nga siguracioni shëndetësor. Ilaçet që nuk i ofrojnë spitalet qytetarët i blejnë pastaj me çmim të plotë në farmaci.

Siguracioni shëndetësor shtetëror ofron shumë pak mjete financiare, shprehet një ish-drejtor që nuk do të përmendet me emër, dhe që për vite me radhë ka drejtuar disa spitale në Serbi. "Kështu në pjesën e dytë të vitit mungojnë gjilpërat, shiringat, dhe dezinfektuesit. Pa harruar pjesët për aparatet e radiografisë." Ndërkohë ai punon tani për një spital privat, që nuk i ka këto probleme.

Mjekët largohen nga vendi

Në të njëjtën kohë nga vendet e Ballkanit po largohen shumë mjekë. "Vitin e kaluar 180 nga 220 mjekë të diplomuar kanë kërkuar një certifikatë që u mundëson punën jashtë vendit", thotë Goran Begoviç, kreu i sindikatës së mjekëve në klinikën qendrore të Shkupit. "Kjo shifër është e frikshme", thotë ai.

Destinacioni më i preferuar është Gjermania, ku një mjek fiton 5 deri në 6 herë më shumë se në Serbi apo Maqedoni. Në vitin 2016, mjekët serbë përbënin grupin e tretë më të madh të mjekëve të lejuar për të punuar në Gjermani, pas sirianëve dhe rumunëve. Organizata Healthgrouper ka konstatuar se më shumë se treçereku i mjekëve në Serbi mendon për t'u larguar nga vendi. Situata është e ngjashme në vendet e tjera të Ballkanit.

Kështu krijohet një rreth vicioz, personeli mjekësor largohet nga vendi ose kalon në sektorin privat, ku pagat janë më të mira. Përballë këtyre qëndron një sistem shtetëror me shumë më pak para dhe mjekë e me lista të gjata pritjeje. Kolapsi i një sistemi të tillë duket si i paraprogramuar. Mirela Shishiç, që duhet të përballet me diabetin e fëmijës së saj në sistemin shëndetësor boshnjak nuk ka shumë shpresa: "Më parë do t'i shkatërroheshin veshkat vajzës sime se sa do të kryhej ndonjë reformë."

(gazeta-Shqip.com) / DW

Sauna ju dobëson? Dieta dhe ushqimet: 10 mite të rreme

Nga sauna që ju bën të humbni peshën, te peshqit që janë plot me mërkur. Portali i ISS (Salute dell' Istituto Superiore di Sanità), ka demaskuar thashethemet më të përhapura në internet në lidhje me të ushqyerit duke ofruar shpjegime shkencore për të kuptuar se çfarë është e vërtetë dhe çfarë është e rreme.



Doni të humbni disa kilogramë shtesë? Bëj një sauna!

FALSE – Një besim i përbashkët thotë se përdorimi i saunës nxit humbjen e peshës, duke ndihmuar në djegien e kalorive. Me siguri duke bërë një sauna mund të sjellë shumë përfitime për trupin tonë, si fizik ashtu edhe mendor. Burimi i madh i nxehtësisë i pranishëm në një sauna, lejon në fakt të përmirësojë djersën, të relaksojë muskujt dhe të pastrojë lëkurën. E gjithë kjo, megjithatë, nuk na lejon të theksojmë se marrja e saunës është e mundur për të humbur peshë. Kjo është në fakt vetëm një ndjesi e pastër dhe e thjeshtë për shkak të faktit që në saunë (duke pasur parasysh temperaturat e larta dhe praninë e avullit) ju djersisni. Por, djersitja nuk korrespondon me humbjen e peshës. Djersa, në fakt, nuk lidhet me humbjen e yndyrës ose me konsumin më të madh të kalorive, por çon në një humbje të konsiderueshme të lëngjeve dhe mineraleve. Këto, megjithatë, brenda disa orëve, rikthehen nga trupi ynë sa më shpejt që të pini ujë ose pije, duke e çuar peshën pikërisht në vlerat e mëparshme. Kështu që është e mundur që të merrni disa rezultate në peshën e trupit tuaj duke bërë saunën, duhet të kombinoni një dozë të duhur stërvitjeje, të plotësoni lëngjet e humbura me shtesat e kripës dhe të ndiqni një stil ushqimi të duhur dhe të shëndetshëm.

Ngrënia e ushqimeve pa gluten është e shëndetshme

FALSE – Në mungesë të kushteve që justifikojnë eliminimin nga dieta të ushqimeve që përmbajnë gluten, është e kështillueshme që të konsumoni ushqime të tilla që të mos e privojnë veten nga ushqyesit që ato përmbajnë. Në Shtetet e Bashkuara (dhe të tjerët) moda e dietës gluten-free po përhapet, madje edhe në mesin e atyre që nuk vuajnë nga sëmundja celiac; sipas mbështetësve të tij kjo lloj diete do të ishte më e shëndetshme dhe do të ndihmonte në humbjen e peshës. Në të vërtetë nuk është kështu. Le të shohim pse. Sëmundja celiac është një formë e intolerancës së përhershme ndaj glutenit që shkakton shkatërrimin e villit të zorrëve, duke rezultuar në keqpërdorim të zorrëve: zorrët nuk janë më në gjendje të absorbojnë hekurin, mineralet, yndyrnat dhe vitaminat. Për një celiac, një dietë gluten-free është thelbësore për të shmangur zhvillimin e mangësive ushqyese serioze. Në të kundërtën, në mungesë të një diagnoze të sëmundjes celiac bërë nga një mjek me teste të përshtatshme klinike dhe diagnostikuese, mos privimi nga ushqimi që përmban gluten nuk rekomandohet. Para së gjithash, sepse heqja e drithërave që përmbajnë gluten, si gruri, elbi nga dieta juaj, do të thotë të privoni veten jo vetëm nga burimet kryesore të karbohidrateve komplekse, por edhe nga mineralet, vitaminat, proteinat dhe fibrat dietale që ato përmbajnë.

Të gjithë peshqit janë plot me mërkur

FALSE – rreziku i gjetjes së niveleve të mërkurit që janë të rrezikshme për organizmin ekziston vetëm për disa lloje peshqish dhe për disa kategori konsumatorësh. Në Itali, megjithatë, importi dhe tregtia e produkteve me origjinë shtazore janë subjekt i kontrolleve strikte. Përmbajtja e mërkurit në peshq ndryshon sipas llojeve: peshqit e mëdhenj grabitqarë, siç janë peshku i shpatës dhe tonti, kontaminohen më lehtë me mërkur se peshqit më të vegjël. Përqendrimet e larta të mërkurit në trup mund të jenë toksike ndaj sistemit nervor të fëmijëve dhe gjatë moshës së fetusit. Sidomos për grupe të caktuara të konsumatorëve, siç janë fëmijët, gratë e moshës riprodhuese, gratë shtatzëna dhe gratë pas lindjes, Autoriteti Europian Food Safety (Autoriteti Europian për Sigurinë e Ushqimit, EFSA) rekomandon të hahet peshk 2-3 herë në javë , duke ndryshuar speciet dhe duke kufizuar konsumin e atyre që mund të kenë një përmbajtje më të lartë metilik, si grabitqarët e mëdhenj (peshkaqenë, peshk shpatë, grep, ton dhe hake).

Për të humbur peshë, thjesht kufizoni makaronat

FALSE – Duke lënë mënjanë ushqimet për të humbur peshë është një metodë që nuk funksionon dhe nuk është e mirë për shëndetin tuaj. Është e zakonshme që heqja e ngrënies është një metodë e vlefshme dhe efektive për të humbur peshën, dhe për fat të keq kjo praktikë është përjetuar nga shumë. Besohet se privimi i trupit të nga kaloritë dhe ushqyesve gjatë gjithë ditës do të zvogëlojë masën e yndyrës. Në realitet, ajo që ndodh është e kundërta: trupi, i privuar nga ushqimi, vazhdon në gatishmëri dhe ngadalëson humbjen e peshës. Kur një vakt anashkalohet, ka një rënie fiziologjike të sheqerit në gjak, me dy pasoja të rëndësishme: së pari, truri është nxitur të dëshirojë ushqim, me një ndjenjë të papërmbajtshme urie dhe mbi të gjitha, çfarë rritet dëshira për karbohidratet mbajini sheqernat në vlera normale. Prandaj, pasi të kalohet një vakt, ju jeni më të uritur se më parë. Mënyra e zgjatur e kapërcimit të mëngjesit, drekës ose darkës, me kalimin e kohës, shkakton humbjen e masës së ligët dhe rritjen e masës së yndyrës, duke shkaktuar gjithashtu ngadalësimin e metabolizmit. Zakonisht, duke lënë mënjanë ushqim, është, në shumë mënyra, një zgjedhje e sëmurë.

Makaronat gjithmonë ju shëndoshin, ananasi ju bën të humbni peshë

FALSE – Nuk ka ushqime të mira ose të këqija: të gjitha ushqimet duhet të përfshihen, në përmasa të drejta, si pjesë e një diete të shëndetshme dhe të ndryshme. Frutat janë një ushqim thelbësor për trupin tonë dhe është e kështillueshme që të konsumoni të paktën 3 pjesë në ditë, të shoqëruar nga konsumimi ditor i të paktën 2 poreve të perimeve. Megjithatë, nuk ka ushqime që ju bëjnë të humbni peshë, ose janë të plotë nga pikëpamja ushqyese: dieta duhet për këtë arsye të ndryshojë dhe të jetë e lidhur me kushtet e personit dhe me aktivitetin fizik që ai / ajo kryen. Plotësisht përjashtoni ushqime të caktuara nga dieta juaj për më shumë se 7-10 ditë mund të shkaktojnë mangësi të mëdha ushqyese. Kjo vlen në veçanti për karbohidratet komplekse (gjenden në makarona dhe bukë): ato janë burimi kryesor i energjisë për trupin dhe mund të jenë aleatë për kontrollin e peshës, sepse ata janë kontribuesit kryesorë në ndjenjën e ngopjes . Përveç kësaj, bukë dhe makarona, sidomos nëse janë integrale, që përmbajnë fibra favorizojnë transitin e zorrëve dhe mbrojnë kundër zhvillimit të tumoreve të zorrës së trashë. Në përfundim, në një dietë të ekuilibruar rreth 60% e kalorive ditore duhet të vijnë nga karbohidratet dhe të paktën 3/4 duhet të merren në formën e karbohidrateve komplekse.

Sheqeri kallam është më i mirë se sheqeri i bardhë

FALSE – Asnjë studim shkencor nuk ka provuar kurrë se sheqeri i kallamit sjell më shumë përfitime se sheqeri i bardhë. Të dyja llojet e sheqerit përmbajnë, në të vërtetë, pikërisht molekulat e njëjta, saharoze, për të cilat ato janë ekuivalente. Në fakt, ndërsa sheqeri i bardhë përmban vetëm saharozë, se kafe, ai gjithashtu përmban disa melasë të mbetur, i cili i jep një aromë pak të ndryshme. Saratroza mund të nxirret nga kallam-sheqeri dhe panxhar sheqeri. Molekula e nxjerrë është saktësisht e njëjtë, por ekzistojnë mbetje dhe papastërti të ndryshme të cilat, para rafinimit përfundimtar, janë ende të pranishme në produktin e papërpunuar dhe të cilat në fund mbeten në melasë. Mbetjet e panxharit nuk janë shumë të këndshme dhe për këtë sukroza që rrjedh prej saj pastrohet plotësisht. Megjithatë, ato që janë të pranishme në kallam sheqeri, janë të dukshëm në shije. Sheqeri i kallamit mund t'i nënshtrohet gradave të ndryshme të rafinimit dhe të çojë në produkte paksa të ndryshme, nga sheqeri i bardhë, i njëjtë me atë të panxharit, deri te produktet më të errëta.

A keni nevojë për hekur? Hani shumë spinaq

FALSE – Spinaqi nuk është një burim i mirë hekuri për trupin. Në fakt, shumica e hekurit të përfshirë në to është e papërdorshme si një lëndë ushqyese, sepse ajo është e pranishme së bashku me substanca që pengojnë thithjen e saj në zorrë. Besimi popullor se spinaqi është një burim i shkëlqyer hekuri është ndoshta pjesërisht për shkak të mbulimit të gjerë të medias që ka pasur disa reklama dhe karikaturat. Hekuri është minerali më i bollshëm në trupin tonë dhe luan një rol vendimtar në formimin e qelizave të kuqe të gjakut. Vlerat e rekomanduara të marrjes janë 10 mg në ditë për të rriturit meshkuj dhe të moshuar dhe 18 mg për gratë gjatë gjithë periudhës së fertilitetit. Është vlerësuar se rreth 2 miliardë njerëz në mbarë botën (më shumë se 30% e popullsisë së botës, si në vendet e industrializuara dhe në zhvillim) janë anemikë dhe, shumica e tyre, për shkak të mungesës së hekurit. Në këto raste është e kështillueshme, në kështillën e mjekut, një dietë që shton mungesën e hekurit.

